



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK**

PROCESVERBAL NR. 10

Rrogozhinë, më 20.10.2025 ora 13 : 00 ^{oo}

Zhvillohet mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak, në sallën e mbledhjeve të Këshillit në katin e dytë pranë ish Bashkisë Rrogozhinë.

Rendi i ditës :

Në mbështetje të shkresës “Njoftim”, të Kryetares së Këshillit Bashkiak me Nr.4435.Prot datë 15.10.2025, me rend dite si më poshtë :

- 1- Miratim i rendit të ditës.
- 2- Miratim i procesverbalit Nr.9, të mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 09.09.2025.
- 3- Miratim i dhënies së mandatit të anëtarit të këshillit bashkiak Rrogozhinë znj. Dhurata Meka.
- 4- Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Shtator 2025 nga fondi i Bllok - Ndihmës 6%”.
- 5- Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Tetor 2025 nga fondi i pushtetit vendor”.
- 6- Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës së menjëhershme ekonomike për familjet në nevojë”.
- 7- Shqyrtim i draftit të “Sistemit të Taksave dhe Tarifave Vendore 2026” për Bashkinë Rrogozhinë.
- 8- Shqyrtim i Relacionit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 të Bashkisë Rrogozhinë.
- 9- Miratim i projekt - vendimit, “Për dokumentacionin dhe kriteret e kërkuara për përfitimin e bursave në arsimin parauniversitar”.
- 10- Miratim i projekt - vendimit, “Për shpalljen qytetar nderi Presidentit të Republikës së Shqipërisë z. Bajram Begaj”.
- 11- Raportim nga drejtoria e financës mbi realizimin e treguesve ekonomike-financiare për 6-mujorin e I-rë të vitit 2025 në Bashkinë Rrogozhinë.
Shqyrtohet i njëjti material i vënë në dispozicion në mbledhjen e datës 19.08.2025.
- 12- Informacion nga drejtoria e politikave urbane për punën e bërë në drejtim të aplikimeve të



lejeve on - line, projekteve të reja, procesin e legalizimit dhe evidentimin e problemeve të kadastrës dhe pronave.

Shqyrtohet i njëjti material i vënë në dispozicion në mbledhjen e datës 19.08.2025.

13- Informacion mbi punën e bërë nga Sektori i Pyjeve dhe përmisimin e shërbimeve dhe veprimtarisë që ofron në këtë fushë.

Shqyrtohet i njëjti material i vënë në dispozicion në mbledhjen e datës 09.09.2025.

14- Analizë nga drejtoria e të ardhurave dhe zhvillimit ekonomik mbi realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve për 9-mujorin e parë 2025.

15- Informacion nga Drejtoria e Bujqësisë mbi masat e marra për pastrimin e kanaleve të para, të dyta dhe të treta dhe përgatitja e tyre për sezonin e dimrit.

16- Shqyrtim i kërkesës së anëtares së Këshillit Bashkiak znj. Silvana Aliu.

17- Të ndryshme.

-Kërkesë nga poeti z.Hekuran Dedej.

Shqyrtohet e njëjta kërkesë e vënë në dispozicion në mbledhjen e datës 15.07.2025.

-Kërkesë për mbështetje financiare të një ekskursioni social-edukativ nga Shoqata Humanitare 3 Dhjetori.

Marrin pjesë Këshilltarët prezentë në sallë :

Shpati Kolgega, Renato Kalemi, Alime Hoxha, Gezime Met-hasani, Altin Tosku, Mitat Daja, Dhurata Meka, Saimir Cani, Besnike Coraj, Merilin Saraçi, Indrit Dedej, Silvana Aliu, Hekuran Xhani, Erind Tosku, Mukades Gixhari.

Mungojnë :

Fatmira Thartori, Enver Memolla, Lulzim Hasa, Lorena Baku, Sokol Gosa, Lije Dedej.

Të ftuar :

1. Edison Memolla - Kryetar i Bashkisë.
2. Andi Proshka - Nënkryetar i Bashkisë.
3. Rezart Vogli - Drejtor i Financës.
4. Tomorr Thartori - Drejtor i Politikave Urbane.
5. Valmira Troka - Drejtore e Shërbimeve Mbështetëse.
6. Ledian Hasani - Drejtor i mbrojtjes dhe kujdesit social.
7. Orges Tosku - Drejtor i Arsimit, Kulturës, Turizmit, Rinisë dhe Sporteve.



8. Marsida Thartori - Drejtore e të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik.
9. Enkela Ballabani - Drejtore e zyrës Juridike.
10. Elton Xhani - Drejtor i Bujqësisë, Veterinarisë, Pyjeve, Kullimit dhe Vadtjes.
11. Besnik Dushku - Shefi i MZSH-së
12. Dorina Shehi - Përgjegjëse e sektorit të kadastrës.
13. Artur Kaja - Përgjegjës i Sektorit të Pyjeve.
14. Ismail Broli - Përgjegjës i Lejeve Zhvillimore.
15. Marjeta Kuqi - Përgjegjëse e Sektorit të Projektimit dhe Menaxhimit të Kontratave .
16. Klea Dushku - Përgjegjëse e zyrës IT.
17. Sidorela Aliu - Specialiste e zyrës IT.

Drejtton mbledhjen :

Mukades Gixhari – Kryetare e Këshillit.

Ndodhen në sallën e Këshillit Bashkiak : Këshilltarët e sipërcituar, si dhe specialistët e Bashkisë që janë thirrur për të shqyrtuar dhe relatuar pikat e rendit të ditës të sektorit që mbulon secili prej tyre, sipas axhendës ditore. Pasi konfirmohet kuorumi i nevojshëm, 13- Këshilltarë, znj Besnike Coraj dhe znj. Merilin Saraçi i bashkohen në vijim mbledhjes së Këshillit (në minutën e 26 të zhvillimit të saj) duke e çuar në 15 numrin e këshilltarëve të pranishëm.

HAPET MBLEDHJA

Mukades Gixhari . Përsëritet të nderuar Këshilltarë ! Meqë kemi kuorumin e nevojshëm mbledhjen e deklaroj zyrtarisht të hapur. Marrin pjesë në mbledhje : z. Shpati Kolgega, z. Renato Kalemi, znj. Alime Hoxha, znj. Gezime Met-hasani, z. Altin Tosku, z. Mitat Daja, z. Saimir Cani, z. Indrit Dedej, znj. Silvana Aliu, z. Hekuran Xhani, z. Erind Tosku dhe Mukades Gixhari.

-Lexojmë Vendimet me karakter individual që u morën në mbledhjen e këshillit të datës 09.09.2025 të cilat hyjnë në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore“, i ndryshuar janë si më poshtë :

Vendim nr . 32 .Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Gusht 2025 nga fondi i Bllok - Ndihmës 6%

Vendim nr . 33 . Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Shtator 2025 nga fondi i pushtetit vendor.



Vendim nr . 34 .Për dhënien e ndihmës së menjëhershme ekonomike për familjet në nevojë. Gjithashtu lexojmë dhe konfirmimin ligjor të ardhur nga prefekti i qarkut Tiranë për vendimet e datës 09. 09.2025:

Vendim nr . 35 .Për miratimin e marrëveshjes për krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta midis njësive të vetëqeverisjes vendore dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore, Akademia e trajtimit të njësive të vetëqeverisjes vendore, akademia e trajnimit të njësive të vetëqeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë (Talga). Konfirmohet në parim referuar ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore i ndryshuar”.

Vendim nr . 36 . Për miratimin e tavanëve përfundimtare të programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore Bashkia Rrogozhinë. Konfirmohet në parim referuar ligjit nr.68/2017 “Për financatë vetëqeverisjes vendore”.

Vendim nr . 37 . Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për mbrojtjen civile. Konfirmohet në parim referuar VKM-së nr.414, datë 08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile, i ndryshuar.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin Prefekt : Afrim Qëndro.

-Kalojmë në pikën e parë.

Mukades Gixhari . Jeni dakort me rendin e ditës? E hedhim në votim pro, kundër, abstenim, të gjithë pro miratohet.

-Miratohet me 12 vota pro, 0 vota kundër, 0 vota abstenim, pika 1 (një) e rendit të ditës.

Mitat Daja . Është hequr një pikë apo jo?

Mukades Gixhari . Po, e thashë. Miratim i procesverbalit Nr.9, të mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 09.09.2025. E hedhim në votim. Pro kundra absenim të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 12 vota pro, 0 vota kundër, 0 vota abstenim, pika 2 (dy) e rendit të ditës.

Mukades Gixhari . Kalojmë në pikën 3, miratim i dhënies së mandatit të anëtarit të këshillit bashkiak Rrogozhinë znj. Dhurata Meka. Atëherë, pasi jemi njohur me vendimin e KQZ-së për dhënien e mandatit të këshilltarit znj. Dhurata Meka, mbështetur dhe në propozimin e komisionit të mandateve, kalojmë në procedurën e betimit.

(Kryetarja dhe znj. Dhurata Meka ngrihen në këmbë dhe kryetarja lexon...)



Betohem në nderin tim se do të kryej me ndërgjegje detyrën e anëtarit të këshillit bashkiak dhe do t'i bindem Kushtetutës dhe ligjeve. Betohem se në të gjithë veprimtarinë time do të udhëhiqem nga interesat e shtetasve të Bashkisë Rrogozhinë dhe do të punoj me ndershmëri e përkushtim për zhvillimin dhe rritjen e mirëqënies së tyre. Betohm.

Dhurata Meka . Betohem.

Mukades Gixhari . Suksese! E hedhim në votim dhënien e mandatit të anëtares së Këshillit Bashkiak znj. Dhurata Meka? Pro, kundër, abstenim. Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 12 vota pro, 0 vota kundër, 0 vota abstenim, pika 3 (tre) e rendit të ditës.

Vendim nr.38. Miratohet me 12 vota propozimi i komisionit të mandateve për dhënien e mandatit të anëtarit të këshillit bashkiak znj. Dhurata Meka, mbështetur në shkresën e ardhur nga KQZ me Nr.6034. Prot datë 11.09.2025 “Njoftim për vazhdimin procedurave për dhënien e mandatit”.

Mukades Gixhari . Kalojmë në pikën 4 Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Shtator 2025 nga fondi i Bllok - Ndihmës 6%”. Relaton drejtori i mbrojtjes dhe kujdesit social z. Ledian Hasani. Përsëendetje z. Ledian fjala për ju.

Ledian Hasani . Në total janë 15 familje dhe fondi është 54 mijë lekë.

Mukades Gixhari . Ndonjë pyetje? Materialin e keni para. E hedhim në votim . Pro, kundër, abstenim. Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 13 vota pro, 0 vota kundër, 0 vota abstenim, pika 4 (katër) e rendit të ditës.

Vendim nr. 39. Miratohet me 13 vota pro, projektvendimi i propozuar nga Kryetari i Bashkisë me shkresë Nr.4413.Prot datë 14.10.2025 “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Shtator 2025 nga fondi i Bllok – Ndihmës 6%”, si dhe Relacioni shpjegues për këtë projektvendim me Nr.4413/1.Prot datë 14.10.2025.

Mukades Gixhari . Kalojmë në pikën 5, Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Tetor 2025 nga fondi i pushtetit vendor”. Relaton po drejtori i mbrojtjes dhe kujdesit social z. Ledian Hasani.



Ledian Hasani . Në total janë 21 familje përfituese dhe fondi është 94 mijë lekë të vjetra.

Mukades Gixhari . Ndonjë pyetje? E hedhim në votim. Pro, kundër, abstenim. Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 13 vota pro, 0 vota kundër, 0 vota abstenim, pika 5 (pesë) e rendit të ditës.

Vendim nr.40. Miratohet me 13 vota pro, projekt-vendimi i propozuar nga Kryetari i Bashkisë, me shkresë Nr.4414.Prot datë 14.10.2025, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Tetor 2025 nga fondi i pushtetit vendor”, si dhe Relacioni shpjegues për këtë projektvendim me Nr.4414/1.Prot datë 14.10.2025.

Mukades Gixhari . Kalojmë në pikën 6. Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës së menjëhershme ekonomike për familjet në nevojë”. Vazhdojmë po me z. Ledian Hasani.

Ledian Hasani . Atëherë janë 3 familje që janë përfituese, çdo familje përfiton nga 50 mijë lekë të vjetra, njëri është në njësinë administrative Kryeviidh dhe dy tjerët në Gosë.

Mukades Gixhari . Ndonjë pyetje? E hedhim në votim. Pro, kundër, abstenim. Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 13 vota pro, 0 vota kundër, 0 vota abstenim, pika 6 (gjashtë) e rendit të ditës.

Vendim nr.41. Miratohet me 13 vota pro, projekt-vendimi i propozuar nga Kryetari i Bashkisë me shkresë Nr.4411.Prot datë 14.10.2025 “Për dhënien e ndihmës së menjëhershme ekonomike për familjet në nevojë” si dhe Relacioni Shpjegues për këtë projektvendim me Nr.4411/1.Prot datë 14.10.2025.

Mitat Daja . Ledian një sekondë kam një pyetje për Shërbimin Social. Janë disa nuk e di, a është tek organika e Shërbimit Social kur invalidi është i pamundshëm për t’i kryer procedurat vetë? Mund të jetë i verbër, mund të jetë me probleme. A ka bashkia në organikë ose Shërbimi Social një njeri që i shërben këtyre njerëzve, ndoshta shofer, ndoshta... ku di unë, një njeri që merret me anën ligjore të rregullimit të letrave për KEMP, sepse ti je drejtor dhe nuk mund t’i bësh të gjitha vetëm një person?Organika e Shërbimit Social në bashki e ka një person të tillë?

Ledian Hasani . Atëherë, ato i kërkon... domethënë, i kërkon komisioni i spitalit atë personin që



ta shohë. Nuk është në varësi të bashkisë pjesa... Ne mund të bëjmë vetëm kaq që mund t'i shkojmë te shtëpia t'ia nxjerrim me videokamatë...

Mitat Daja . Po ju si Shërbim Social nuk e ofroni këtë shërbim? Sepse ka dhe invalidë që...

Ledian Hasani . Nuk më beson komisioni po se pa vetë atë të sëmurin nuk beson; duhet ta shohë vetë çfarë gjendje është...

Mitat Daja . Nuk ma kuptove, për shembull, ka këtu invalidë që janë me dializë?

Ledian Hasani . Po.

Mitat Daja . Dhe ato kanë nevojë për transport.

Ledian Hasani . Atëherë, ato që janë me dializë i rimbursen shteti, i paguan atë pjesën e transportit te pagesa që i bëhet...

Mitat Daja . Po më përpara ka pas... ka pas marrë përpara në bashki?

Ledian Hasani . Jo.

Mitat Daja . Asnjëherë s'është rimbursuar nga bashkia?

Ledian Hasani . Sa kam unë, sa kohë kam unë...për dializë jo.

Mitat Daja . Pra, shteti jep aty te ai KEMP-i që jep.

Ledian Hasani . Tek diagnoza që kanë ato parashikohet, domethënë, në buxhet te ministria; parashikohet dhe aty i shtohet pagesa.

Mitat Daja . Po bashkia nuk duhet të ketë një makinë që t'i transportojë këta? Shërbimin Social...

Silvana Aliu . Po ta them unë se, se nuk po del drejtpërdrejt. Makina që keni pasur, ku e keni?

Ledian Hasani . Makina aty është... në servis është... makina është për ne për shembull, për



rastin që është bërë kërkesa në Kryevindh, kam marrë makinën e bashkisë dhe kam shkuar për verifikim ... në Gosë, kam shkuar...

Mitat Daja . Po flasim në përgjithësi si shërbim duhet të ofrohet dhe, nëse nuk ofrohet, pse s'ofrohet?

Ledian Hasani . Po varet se çfarë është shërbimi. Domethënë, për dializë nuk ofrojmë shërbim.

Mitat Daja . Për dializë nuk ofrohet shërbim?

Ledian Hasani . Jo.

Mitat Daja . Nuk është e mundur që të ofrohet shërbim që këta njerëz t'i lehtësohen pak... ?

Ledian Hasani . Duhet me parë buxhetin.

Mitat Daja . Po dakord, sepse ne jemi dhe para përgatitjes së buxhetit. Mund të shikohet...shiko duhet me pa dhe anën ligjore; se ne s'mund të dalim dot jashtë...

Ledian Hasani . Nuk e mbulon dot, se mund të jenë shumë dializë, s'e mbulon dot ashtu.

Mitat Daja . Po të gjendet mundësia të mbulohet, sepse në qoftë se nuk mbulohen këto që janë të sëmurë... i bie që... Sa mund të jetë kosotoja? Sa veta janë me dializë këtu në Rrogozhinë, në bashkinë Rrogozhinë?

Ledian Hasani . Nuk e di...

Mitat Daja . 10 veta?

Ledian Hasani . Po mund të jenë më tepër. Mund të jenë më tepër.

Mitat Daja . Po duhet me u bë ky lloj studimi.

Ledian Hasani . Si?

Mitat Daja . Duhet me u bë ky lloj studimi. Për njerëz ofrohet transport . Tani unë nuk po...



edhe njëherë kjo nuk është pyetja që vjen, a është shpallur nëpër mur dikush, ky është një sugjerim që mund të bëhet edhe Reni është doktor dhe mund të na e shpjegojë pak.

Renato Kalemi . Të ndërhyj pak se është pjesë që prek pacientët e dializës?

Mukades Gixhari . Po, z. Renato.

Renato Kalemi . Atëherë, pacientët e zonës së Rrogozhinës e marrin shërbimin te spitali Amerikan në Durrës. Problemi është që këto pacientë nuk janë të fokusuar vetëm në qendër të Rrogozhinës, janë në fshatra dhe çfarë mund t'i marrësh me mjet e t'i çosh në spital se bëjnë tre herë javë, nga katër orë. Me sa kam informacion unë, në asnjë vend të Shqipërisë nuk ofrohet asistencë nga spitali, për ambulancë. Për pjesën e bashkisë nuk di të them, tani çdo pacient dialize merr rimbursim me pagesë nga shteti, llogarit km dhe shteti i jep një faturë mujore, tani e lartë e ulët tek kjo pjesë nuk do futem por që çdo pacient dialize merr tek kjo pjesë.

Mitat Daja . Sa është pak a shumë, ka ndonjë tarifë?

Renato Kalemi . Në bazë të kilometrave.

Mitat Daja . Edhe nuk ofrohet nga asnjë lloj bashkie?

Renato Kalemi . Jashtë Shqipërisë ka plot vende që ambulanca e merr nga shtëpia e çon në spital. Po tek ne nuk kemi ato kushte...

Mitat Daja . A nuk duhet të bëhet një studim? Le të bëhemi ne bashkia e parë që e bëjmë këtë lloj pune. Ka ndonjë gjë këtu të bëhet një studim, ndoshta përballohet? Po s'ka... nuk ka ndonjë gjë këtu; mund mos bëhet fare dhe ndoshta bëhet. Prandaj them mund të merret si një propozim.

Edison Memolla . Të nxirren emrat të mbahet si propozim .

Mitat Daja . Prandaj po them mund të merret si propozim, bëhet studim dhe shikohet mundësia financiare, nëse ka buxhet ska ndonjë gjë këtu ajo është për ndihmë për njerëzit për mirë nuk është për keq. Dakord. Pra, mund ta marrësh këtë propozim dhe të bëhet një studim për këtë dhe e shohim te buxheti që do bëhet.

Edison Memolla . Tek buxheti i ri që do bëhet kush ka propozime...



Alime Hoxha . Këto janë propozime që i përkasin buxhetit jo tani, tani jemi tek pjesët tjera do diskutojmë këto që kemi në rend dite. Propozimet që keni i bëjmë kur të bëhet buxheti...

Mitat Daja . Atëherë do ta bëj unë propozimin, po fillimisht pyeta drejtorin e Shërbimit Social: ekziston apo s'ekziston tani, kur të bëhet buxheti

Alime Hoxha . Ke 10 minuta që flet për të njëjtën gjë...Tani kemi 15 pika.

Mitat Daja . Po mirë... Po flisni vetëm ju...

Alime Hoxha . Jo, ti fol për ato që janë në rend dite. Unë nuk po them “mos fol”.

Mitat Daja . Po mirë. Ne kemi të drejtën e fjalës të gjithë.

Alime Hoxha . Unë s'të hoqa të drejtën e fjalës nuk ja heq njeriu.

Mikades Gixhari . Mitat i mbajtëm shënim ato gjëra.

Mitat Daja . Faleminderit.

Mukades Gixhari . Vazhdojmë tani me pikën tjetër. Jemi te pika shtatë: shqyrtimi i draftit të sistemit të taksave dhe tarifave vendore 2026 për bashkinë Rrogozhinë. Relaton drejtoresha e të ardhurave dhe zhvillimit ekonomik, znj. Marsida Thartori dhe drejtorët të tjerë sipas rastit, meqë janë të pranishëm. Përshëndetje!

Marsida Thartori . Përshëndetje! Siç e diskutuam edhe në komision në ditën e premte, është bërë një shqyrtim i draftit paraprak të sistemit të taksave, tarifave që do jetë për vitin 2026. Përgjithësisht ka ndryshime ligjore, janë reflektuar dhe projektin taksën mbi ndërtesën dhe taksën mbi ndikimin në infrastrukturë. Ndërsa tek pjesa e tarifave kemi dy propozime një propozim është për heqjen e tarifës për tregun ditor që është për fshatarët e zonës që shesin në qytet, dhe tjetra është për taksën e ndikimit në arsimin parashkollor që e diskutuam dhe kemi lënë që do ta bëjmë edhe një diskutim në dëgjese publike. Po, do bëhet dhe një dëgjese publike për këto do të diskutojmë.

Indrit Dedej . Kemi pikën shtatë... pikën tetë... për dëgjese publike.

Marsida Thartori . Po ndryshimet që janë bërë aktualisht, ku prekin...



Indrit Dedej . Jo, unë them meqë e lamë ditën për dëgjese publike e lamë...

Marsida Thartori është bërë dhe një investim aty që është parashikuar në buxhet dhe investimi është përfunduar.

Erind Tosku . Është për tregun ditor po bëhet pak problem, bëhet problem si nga pjesa e hyrje-daljeve nëpër lagje, si për pjesën e këmbësorëve, kalimin, bllokimin e trotuarit, në qoftë se nuk e keni parë, bëni një xhiro tjetër... Duhet të gjeni zgjidhje për tregun. Është bërë shumë mbledhje, shumë gjëra, po duhet të gjeni zgjidhje edhe tek dëgjesa publike që do bëni edhe qytetarët dhe personat që shesin ambulantë të gjeni vend. Nuk mund të kaloni dot me karrocë te tregu ku është aktualisht, që kemi bërë spostimin nga sheshi i madh; keni çuar te pjesa e rrugicës.

Indrit Dedej . Po, thjesht sistemim ka ai për aq sa mban.

Edison Memolla . T'ju them diçka për pjesën e tregut?

Erind Tosku . Ndërkohë trotuari, ndërkohë rrugët hyrëse të lagjeve gjithashtu ndodhet akoma problem, domethënë nuk jam kundër kësaj pjese është shtyrë kaq gjatë ky vendi ku do vendosim tregun, s'po e dimë se çfarë zgjidhje do japim.

Edison Memolla . Tani, aty është bërë një investim, besoj që sot kanë shkuar edhe ato të rregullohen ato tezgat duke bërë me mbulesa, me të gjitha është parashikuar prapë një provë nuk mund të themi që jemi përfundimtarë që aty mos parkojnë asnjë makinë tek vendi që shitet; të parkojnë makinat, vendoset disa për tregun ditor dhe makinat që do shesin do shkarkojnë gjërat dhe do ikin nga aty; do rrijnë vetëm shitësit bashkë me gjërat që kanë. Do i kemi në survejim ka porosi policia bashkiake, Drejtoria e Shërbimeve dhe mendoj që me pjesën e investimit që është bërë besoj do jetë diçka më ndryshe. Tani, nëse nuk do funksionojë,...

Erind Tosku . Tregu ditor deri çfarë ore do jetë?

Edison Memolla . Tregu ditor deri 12:30.

Erind Tosku . Se po ndenji ditor sot, ditor nesër... bëhet mujor pastaj. Domethënë, në qoftë se ditor... ka një orar, për shembull, nga 8:00 deri në orën 13:00 deri në 14:00 apo 15:00.

Edison Memolla . Aq është ai deri në orën 12.



Erind Tosku . Kështu që besoj... edhe këtë pjesë ta kemi parasysh.

Marsida Thartori . Ne motivohemi me heqjen e tarifës që ajo...

Erind Tosku . Dakord nuk jam kundër... Organizoni edhe një rregull për gjithë qytetarët, ta dinë që tregu ditor zgjat deri në orën 12, pastrohen tezat dhe ikin të gjithë edhe në shtëpi.

Indrit Dedej . I plotëson ai treg aq nevoja sa ka, Sa tregtar ka?

Edison Memolla . Po janë... Sa tregtarë ishin? Janë 12 tregtarë të përditshëm të tregut ditor, që prodhojnë prodhime nga Rrogozhina , po flasim ditor të qytetit, jo ditor...

Indrit Dedej . Unë jam shumë dakord...

Silvana Aliu . Jo, të zgjasi deri në 12 se jemi në punë... Kështu të paktën ë zgjasi deri në 3.

Erind Tosku . Po pra, caktoni një orar që dimë që deri në atë orë.

Edison Memolla . Rreth orës një aty, aq zgjat më shumë sepse më vonë nuk rri njeri.

Indrit Dedej . Po mos parkojnë makinat aty vetë bëhet super i rregullt, sepse treg ka edhe në mes të Tiranës tek stacioni i trenit të jetë estetik i bukur.

Erind Tosku . Jo, nuk jam kundër.

Edison Memolla . Kur të kaloni lart, e shikon...

Indrit Dedej . Aty e ka zënë rrugën dy-tre që janë nëpër cepa ato do të lëvizin, se po shkuan tezat, shkojnë te tezat, kjo është.

Edison Memolla . Këtu jemi dakord për këtë pjesë që të shesin...

Indrit Dedej . Po plotësuan nevojat... është shumë i rregullt.

Edison Memolla . Po policia bashkiake, drejtorja e Shërbimeve ka planin gati, për çdo shqetësim dhe çdo mundësi që nuk mund të shkojë, ne jemi të gatshëm që të na thoni dhe ta bëjmë sa më mirë këtë kisha.



Alime Hoxha . Tani, tek plani juaj, ju çfarë keni parashikuar për të ndryshuar?

Marsida Thartori . Siç e diskutuam në komision, janë ndryshuar: taksa e ndikimit në infrastrukturë është ndryshuar si pasojë e VKM-së dhe kjo prek pak edhe taksën e ndërtesës. Ky ndryshim VKM-je prek dy pika të taksës së ndërtesës. Gjithashtu ne parashikojmë që të shtohet taksa e ndikimit në infrastrukturën arsimore dhe kemi lënë të diskutohet në dëgjese publike, gjithashtu nga komisioni.

Alime Hoxha . Si e parashikoni ta merrni këtë taksën për arsimin parashkollor?

Marsida Thartori . Nga diskutimet që bëmë të premtën, që folëm, ishte dhe Eneida. menduam që ta shtrijmë tek biznesi i madh pastaj, nga diskutimet dolën që mos të rëndojmë vetëm biznesin e madh, po t'i prekim nga pak edhe familjet, edhe biznesin e vogël, edhe biznesin e madh, që mos rëndohet vetëm një shtresë, por ta kemi përgjegjësi sociale secili nga ne. Është një taksë e përkohshme do shtrihet në tre vjet dhe buxheti i të ardhurave që do mblidhen nga kjo taksë do shpërndahen në mënyrë transparente vetëm për arsimin parashkollor. Domethënë, do jenë me destinacion që në momentin që do mblidhen. Dhe kjo u diskutua në komision dhe thamë që do ulemi me grupet e interesit kur të kemi dëgjesat publike.

Indrit Dedej . Edhe familjarët që janë në të njëjtën rrugë... marrin taksë më shumë?

Marsida Thartori . Është përgjegjësi sociale e secilit nga ne; ndoshta nuk kemi një fëmijë në shkollë sot, po mund të kemi një nip, një mbesë...

Silvana Aliu . Gjithmonë duke hequr pensionistët dhe shtresat në nevojë.

Marsida Thartori . Patjetër, patjetër.

Indrit Dedej . Pastaj shohim se sa transparencë kemi

Marsida Thartori . Jo, kjo taksë është e monitorueshme shumë kollaj.

Indrit Dedej . Nuk kontrollohen te gjithë rojet e bostanit.

Marsida Thartori . Jo, është e monitorueshme shumë kollaj, se që në momentin që arkëtohet, arkëtohet me një kod dhe në momentin që do shpenzohet, do shpenzohet po me të njëjtin kod, kështu që monitorohet, është e gjurmueshme. Gjithashtu, ne diskutuam edhe pak për pjesën e



tarifave në qytet dhe për ta ndarë qytetin në dy zona për pjesën e tarifimit por që nga komisioni nuk u dakordësua.

Silvana Aliu . Ramë dakord që qyteti të ishte zona A dhe lart stacionit ta heqim këtë idenë të shkojë shërbimi qytetari.

Edison Memolla . Jemi të gatshëm të presim çfarë lloj propozimi dhe...

Mitat Daja . Po se s'kishte... s'ka arsye pse të ndahet në dy pjesë, i rikthehemi ndarjes së vjetër.

Marsida Thartori . Jo, po nxjerr propozime që dolën... diskutime që dolën...

Edison Memolla . Nëse keni propozime të reja ...

Indrit Dedej . Unë kam një propozim që të hiqet ajo fshat qytet, të hiqet ajo barriera që ka qenë, para '90-ë, Shyqyr që e përmendët kanalin, ti, kanali s'ke qenë vetë aty, kur nuk e di kush i kontrolluar ato

Alime Hoxha . E bëjmë këtë te "Të Ndryshme".

Indrit Dedej . Ju ndoshta e keni parë vetëm kështu, nëpër distanca... Shyqyr që ma përmende kanalin.

Mukades Gixhari . Atëherë, jemi të qartë për këtë pikë, për drejtoreshën... për Marsidën. Faleminderit. Kalojmë në pikën tetë. Mos u largoni. shqyrtimi i relacionit të programit buxhetor afatmesëm 2026–2028 të Bashkisë Rrogozhinë. Relaton drejtori i financës, zoti Rezart Vogli Përsëndetje, zoti Rezart.

Alime Hoxha . Po ju e keni konsultuar... konkluzionet? Nëse e keni konsultuar, na thoni çfarë konkluzionesh keni nxjerrë te...

Silvana Aliu . Domethënë, që ne do të dëgjojmë në dëgjësë publike propozimet që do bëhen atje...

Alime Hoxha . Komisioni, çfarë propozimesh nxorët?



Indrit Dedej . Dëgjo, të lutem... E lamë që të bëhet dëgjesë publike para se sa ta shoh...

Mukades Gixhari . Po, zoti Rezart, fjala për ju.

Rezart Vogli . Përshëndetje të gjithëve. Ashtu siç parashtrua dhe me këshilltarët në ditën e premte, në diskutim me komisionin u ra dakord që, krahas propozimeve dhe kërkesave që vetë bashkia do parashtrojë në projekt-buxhetin afatmesëm, t'i kërkohej dhe këshilltarëve që brenda mundësive të bashkëpunojmë të na sugjerojnë ku kanë nevojë për ndërhyrje, për investime apo për... nuk e di, për çfarë nevojash ka komuniteti, të na i dërgojnë që t'i përfshijmë në projekt-buxhetin afatmesëm që do shqyrtojmë ditën e konsultimit.

-I bashkohen mbledhjes znj. Besnike Coraj dhe znj. Merilin Saraçi në minutën e 26 të zhvillimit të mbledhjes.

- Shkëputet zëri në mbledhje nga minuta e 23 deri 30 të zhvillimit të mbledhjes për arsye të panjohura.

Përgjatë kësaj kohe drejtori i financës prezanton PBA në mënyrë të përgjithshme dhe kalohet tek pika 9 e mbledhjes së këshillit, Miratim i projekt - vendimit, "Për dokumentacionin dhe kriteret e kërkuara për përfitim të bursave në arsimin parauniversitar", ku fjalën e ka drejtori i arsimit.

Orges Tosku . Vjet kemi pasur 20 kuota nga Ministria e Arsimit, 20 kuota nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit. Aplikime ne patëm 32, 12 kuota jemi për me fondet e bashkisë.

Hekuran Xhani . Kriteret bazë, tani, dhe kush do t'i informojë ata qytetarë në nevojë...?

Orges Tosku . Atëherë kemi edhe drejtoreshën e ZVA-së që është këtu, edhe të gjithë drejtorët e shkollave i informojmë kur hapen kuota domethënë edhe për dokumentacionin që kërkohej.

Hekuran Xhani . Sepse edhe vjet diskutuam ne për një familje, dy më pas një familje...

Orges Tosku . Atëherë, ne diskutuam edhe herë tjetër...

Hekuran Xhani . Dhe thamë që do ta shtojnë edhe besoj nuk u bë ajo lista shtesë.

Orges Tosku . Ne e kemi miratuar në datë 31 dhjetor. Ajo është faj i drejtorit të shkollës që nuk ka sjellë emrat.



Erind Tosku . Po pra, do njoftohen të gjithë drejtorët e shkollave.

Orges Tosku . Po, po edhe vjet janë njoftuar

Silvana Aliu . Pse nuk dilni në terren vetë e verifikoni? Sepse aty mund të jenë 15 dhe drejtori i shkollës sjell ato pesë-gjashtë që do vetë.

Orges Tosku . Ajo është më e verifikueshme, normalisht që drejtori ka më të evidentuar rastin.

Silvana Aliu . Po, por vjet jam me atë që thotë Hekri.

Orges Tosku . Pastaj, thotë edhe VKM-ja që drejtori është përgjegjës.

Silvana Aliu . O Ed vjet kemi lënë katër fëmijë me aftësi të kufizuar në Gosë, me sa mbaj mend, që i pruri...

Orges Tosku . Jo për fajin tonë.

Silvana Aliu . Nuk do me e futur drejtori atë.

Hekuran Xhani . Nuk është në dëshirën e drejtorit ajo ai paguhet nga taksat e qytetarëve shqiptarë për t'i shërbyer komunitetit.

Orges Tosku . Duhet çdo njeri të bëjë detyrën e vet.

Hekuran Xhani . I kërkohet llogari pra, pse se ke bërë. Iku një vit pa u trajtuar kush mban përgjegjësi për këto dy familje? Në fund të fundit shteti e ka hequr për ta subvencionuar ne nuk ja çojmë, kush mban përgjegjësi

Silvana Aliu . Kjo është diçka për t'u verifikuar, sepse kanë shkuar pesë , gjashtë fëmijë; dy fëmijë kanë qenë nga një familje motër e vëlla të tjerët këtij matanë. Tani, verifikoni se... Edison Memolla . Ne do i verifikojmë dhe ne, edhe ju nëse keni paqartësi, keni emra të tjerë që nuk na kanë hyrë nee këtu jemi, s'jemi fund...

Orges Tosku . Ne nuk na ka ardhur një emër dhe e kemi lënë pa bursë. Aty ka familje që kanë edhe tre fëmijë dhe kanë ...



Edison Memolla . Do t'ia lësh detyrë përgjegjësit të zyrës që merret me këtë punë, krahas drejtorëve të shkollës që do të bëjnë punën e vet; edhe ne do bëjmë punën tonë, që do bëjmë verifikimin, a janë të vërteta ato që duhen, apo s'janë të vërteta? A kanë ngelur jashtë, apo s'kanë ngelur? Kështu që e marrim ne përgjegjësinë dhe e bëjmë.

Indrit Dedej . Do them një të bukur kisha një gjyqtare thoshte: ishte një psikologe edhe sillte raporte ... edhe unë, tha, u ngrija si gjyqtare dhe shkoja e verifikoja vetë që ishte e vërtetë ajo që më thoshte psikologia apo jo... Këtu e ka dhe Silvana ...Besueshmëria duhet të jetë, por përderisa ne konstatojmë që besueshmëria nuk ka ardhur aty ku duhet dhe fëmijët kanë ngelur kështu...

Edison Memolla . Ok. E kemi marrë përsipër që ta bëjmë edhe ne shtesë, krahas sa...

Alime Hoxha . Tani, njoftimi u ka shkuar drejtorëve; dhe nxënësve u ka shkuar. Por problemi është se aty ka kriteret që duhen plotësuar për ta marrë ndihmën ekonomike. Dhe këtu ka dhe një diçka tjetër siç thotë Orgesi sivjet kanë qenë miratuar edhe 20 dhe ne çuam kemi 32. Nëse sivjet do vazhdojë akoma me këtë, do shkojnë jo 32, por 62; dhe ministria nuk besoj se do sjellë më shumë se 20..aq sa do këtë.

Orges Tosku . Jo, ministria jo.

Edison Memolla . Ne do t'i kërkojmë një kërkesë ministrisë.

Alime Hoxha . Po prandaj po, dakord. Por duhet me i shikuar mirë edhe këto kriteret që janë, se po ishte për kështu me mesatare 9-10 ke shumë...

Orges Tosku . Atëherë, kriteret i ka vendosur VKM-ja, ne thjesht i zbatojmë.

Alime Hoxha . I zbatoni po mos e ler 9 deri 10 çoje deri 10. Do të vijë më shumë pastaj dhe nuk e di...

Edison Memolla . Presim kuotat që do vijnë... çfarë kemi mundësi nga ana e bashkisë, ne do ta ndajmë edhe tek dëgjesa publike.

Mitat Daja . Bashkia të llobojë që të marrë më shumë kuota.



Alime Hoxha . Nëse ne do nisemi vetëm për nxënësit me AK të paktën janë 22 nxënës me AK. Kështu që kjo duhet parë një çik më mirë që mos t'i çojmë emrat dhe mos ta marrë pastaj

Edison Memolla . Edhe nga ana juaj do të niset një kërkesë edhe nga ne do të niset një kërkesë të kërkojmë kuota më shumë të paktën minimumi aq sa kanë qenë vjet, pastaj çfarë dalin tepër...

Alime Hoxha . Po që duhet parë mirë kjo duhet parë se pastaj, në qoftë se çojmë më shumë se ç' duhet...

Hekuran Xhani . Janë disa që dihen p.sh ja ajo familje që ti...

Alime Hoxha . Atëherë hiqe këtë që kemi mesatare dhe merre atë që ke me ndihmë ekonomike.

Hekuran Xhani . Atë e ndihmonte, të fëmijën e tij se të shumtët kanë pesë lekë në xhep ai blenë atje kanë një lokal atje.

Alime Hoxha . Do të propozoj ta bësh më para afatin e sjelljes së dokumentacionit mos e lër në afat të fundit që të bëjmë njëherë një verifikim sa kemi dhe pastaj të shikojmë se sa mund t'i sjellin.

Edison Memolla . Ju mund ta nisni që sot njoftimin. Urdhëroni drejtorëve të shkollës, sa e kanë kuotën me këtë mesatare që kemi.

Mitat Daja . Drejtorët sjellin gjithë çfarë kanë, pa bërë dallim edhe të shikohet mundësia që të shtohen, kuotat kaq.

Edison Memolla . Të gjithë drejtorët, besoj, që do e kemi mirëkuptimin të sjellin një kërkesë paraprake që ta dimë sa ka çdo shkollë. Nëse gjithë shkollat bëjnë 50, ne t'i çojmë një kërkesë ministrisë, bashkëngjitur gjithë dokumentacionin që ne kemi kaq, ju lutem, merrni masa për kaq.

Silvana Aliu . Edhe diçka tjetër Gesi ndaji kuotat çdo njësi administrative të ketë kuotat. Jo, ndahen, ...

Edison Memolla . Po ngelën bosh, si do lëmë bosh?

Silvana Aliu . Ku ka bosh ? Ne s'po i gjejmë më ashtu.



Orges Tosku . Ne i kemi mbuluar të gjithë. Në momentin që nuk i mbulojmë dot, do ndahen normalisht.

Hekuran Xhani . Prioritet duhet të jenë fëmijët nxënës të familjeve në nevojë. Pra edhe kriteri 9-10 ai që ka shkuar te 9-10 ja ka sjellë i themi ne edhe Zoti mbarë, të jetë më mirë ekonomikisht, ekonomia është ajo që ndikon drejtpërdrejt edhe në nivelin e arsimit edhe në nivelin e mirëqënies kështu që le t'i jepet prioritet këtyre familjeve që Lediani i ka atje, që i dihet që prindërit janë me aftësi të kufizuara, me gjëra, sepse këtu unë gjykoj që është diçka më humane sesa ai që ka mesataren 10.

Orges Tosku . Këtë vjet ne i kemi plotësuar të gjithë këtë vit që vjen...

Edison Memolla . Ok, e lam që do çojmë kërkesë.

Mukades Gixhari . Vazhdojmë me pikën 11, raportim nga drejtoria...E hedhim në votim. Votat: pro, kundër, abstenim. Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 15 vota pro, 0 vota kundër, 0 vota abstenim, pika 9 (nëntë) e rendit të ditës.

Vendim nr.42. Miratohet me 15 vota pro projekt-vendimi i propozuar nga Kryetari i Bashkisë me shkresë Nr.4344.Prot datë 09.10.2025 “Për dokumentacionin dhe kriteret e kërkuara për përfitimin e bursave në arsimin parauniversitar” si dhe Relacioni Shpjegues për këtë projektvendim me Nr.4344/1.Prot datë 09.10.2025.

Mukades Gixhari . Kalojmë në pikën 11 të rendit të ditës. Raportojmë nga Drejtoria e Financës mbi realizimin e treguesve ekonomikë e financiarë për 6-mujorin e parë të vitit 2025 nga bashkia Rrogozhinë. Shqyrtohet i njëjti material i vënë në dispozicion në mbledhjen e 19.08.2025. Relaton drejtori i financës, z. Rezart Vogli. Përsëndetje!

Rezart Vogli . Përsëndetje! Ashtu si the, unë e solla herën e parë dhe e relatova herën e parë gjithë problematikën. E vetmja gjë që ngeli ishte pyetjet dhe përgjigjet që kishin këshilltarët. Pothuajse e përfundova gjithë relacionin në mbledhjen e kaluar. Thjesht nëse ka, nëse ka një diskutim, nëse ka një paqartësi të ai informacion ...

Mukdes Gixhari . Nga Këshilli?



Mitat Daja . Kam disa pyetje. Po t'i mbaroj të gjitha, pastaj kush ka ndonjë pyetje tjetër ta bëjë pastaj.

Mukades Gixhari . T'i japim radhë dhe të tjerëve z. Mitat.

Mitat Daja . Mirë dakord po bëj vetëm këtë që kam. Te faqja ku flitet për realizimin e investimeve në tre vitet paraardhëse dhe për gjashtëmujorin e parë të vitit 2025. Te buxheti ke thënë: “Buxheti i shtetit, investimet janë 56 milionë”, apo jo , 484?

Rezart Vogli . Cila faqe, zoti...?

Mukades Gixhari . Te cila faqe ishte, zoti Mitat?

Mitat Daja . Realizimi i investimeve. Po s'ka numër faqe këtu që ta them faqen fiks. Realizimi i investimeve për 2025, gjashtë mujori i parë, këto faqet e fundit fare, kjo tabela këtu më qartë...Po s'ka numër faqe. Çfarë them unë tani? A numërojmë faqet? Po, të dija atë pyetjen, ja kisha shpjeguar vetë vetes time, por ngaqë se di. Ja, më jepja, ja u zgjidh problemi. Na falni për vonesën. Për doja të m'i shpjegonit. Ka dhe disa gjëra të tjera aty mbrapa...

Silvana Aliu . Po, merre me ngadalë.

Mitat Daja . Në qoftë se kanë kolegët tjerë ndonjë pyetje, po i lë radhë atyre. Po e pashë tani, është bërë “një toka, troje, terrene, rrugë investimesh”. Çfarë lloj investimesh janë këto që janë bërë nga buxheti i shtetit? Se po e njëjta shumë, ashtu 56 484 ... 56 484 janë bërë investime nga buxheti i shtetit, apo çfarë lloj investimi është ky?

Rezart Vogli . Ku e lexon atë 554...? Çfarë paragrafi është kjo? Ky është totali ti do shpjegim çfarë është bërë?

Mitat Daja . Po çfarë është bërë me këtë edhe këto mjetet e veta, një shpjegim financiar kuptueshëm.

Rezart Vogli . Mjetet e veta është totali i këtyre mjeteve poshtë, investime që janë bërë poshtë. Buxheti i shtetit është totali i këtyre ... Atëherë, në bashkinë e Rrogozhinës janë bërë disa investime në lidhje me fondet e akorduara nga buxheti i shtetit. Zëri është specifik, është llogaria ekonomike që i përfshin të gjitha bashë këto.



Hekuran Xhani . Buxheti vjetor me të ardhurat nga buxheti i shtetit, sa milionë është dhe sa janë shpenzuar deri për 6- mujorin e parë? Sa është realizuar?

Mitat Daja . Po, po, për këtë po. Dhe ku janë shpenzuar, ka ardhur buxheti i shtetit, ku janë shpenzuar?

Hekuran Xhani . Viti, ne kemi shpenzuar 40 milionë për këtë gjashtëmujor. Na kanë mbetur 60 milionë për gjashtëmujorin tjetër. Ku është bërë investimi?

Rezart Vogli . Jo, ajo është e drejtë, është e drejtë shqetësimi që ngriti zoti Mitat, po...thjeshtë analitike unë nuk e kam për momentin që të them: ky zë kaq, ky zë kaq, ky zë kaq, e kam në total.

Mitat Daja . Herë tjetër të na japë një përgjigje. Po, mund të japësh një përgjigje herë tjetër për këtë lloj për investimet që janë bërë.

Erind Tosku . Nga cila drejtori pritet më shumë fokusim? Te Drejtoria e Financës domethënë, apo Drejtoria e Urbanistikës?

Rezart Vogli . Nga drejtoria e urbanistikës, urbanistika që ka projektet dhe investimet,

Erind Tosku . Nga ato prej atyre kemi fokusuar më shumë pjesën e investimeve, në këtë rast buxhetit.

Rezart Vogli . Patjetër, patjetër, është e vetmja drejtori që mund të bëjë projekte.

Erind Tosku . Presim ndonjë realizim të tyre?

Rezart Vogli . Patjetër po.

Hekuran Xhani . Dikur kemi pasur shumë debate, transparencë kaluam një investim nga qeveria lidhur me rehabilitimin e një rezervuari këtej nga Kryevidhi. Çfarë është bërë me projektin?

Edison Memolla . Atëherë, projekti është hedhur për tenderim. Normalisht ka ato afatet e veta, se gjithmonë ka ankesa, KPP-ja, të gjitha këto gjëra janë bërë duke respektuar të gjitha afatet. Dhe tani është prapë në tenderim, dhe akoma nuk... sepse janë afate që çdo firmë ka të drejtën e ankimimit, ka të drejtën e kërkesës, ka shumë të drejta. Dhe besoj, që në fundi apo në fillim të



muajit tjetër, nëse nuk do ketë më problematika apo ankesa të ndryshme, do të shkojmë me përfundim fondi, shkojmë me lidhje kontrate. Por janë ca kohë që ne s'i shmangim dot, se duhet t'i respektojmë të gjitha ligjet që ka në fuqi shteti. Është në tenderim akoma.

Mitat Daja . Tani unë kam një pyetje për këtë, për borxhin, punën e borxhit, se ky borxhi na vret të gjithëve. Këtu thotë 161 milionë borxhi, edhe ka një rritje të borxhit, këtu në këtë rast thotë ke rritje, tek OSHE-ja. Po nuk janë paguar nuk është puna që është bërë shërbim edhe...

Edison Memolla . Atëherë, të flasim për pjesën e borxhit realisht, kur kemi ardhur para pesë vitesh afërsisht, ka qenë rreth 2.6 miliardë lekë borxhi i Bashkisë Rrogozhinë. Mitat Daja . Ndaj OSHE-së pse janë rriturborxhet ndaj OSHE-së? T

Edison Memolla . Ta thjeshtoj, 2.6 kemi bërë vit pas viti nuk kemi bërë investime me buxhetin e bashkisë kemi qenë që të shkojmë sa më shumë te firmat që kanë bërë punët, t'u rikuperohet ajo e ardhur që ato kanë pasur. Kemi ulur borxhin deri në një farë mënyre, por duke mos paguar njërin, rritet tjetri.

Mitat Daja . Nuk është dëgjese publike kjo, kjo është relacioni që ka sjellë. Nuk ka lidhje me dëgjuesen publike kjo apo jo?

Edison Memolla . Nuk ndërpret energjinë elektrike, por thjeshtë ne do të bëjmë marrëveshje. që herë pas here të bëjmë pagesën. Ne paguajmë për OSHE-në, por nuk arrijmë të paguajmë 100% të gjithë.

Mitat Daja . Sepse duke u vonuar borxhet, këtu thotë “ka një zë që thotë shërbimet përmbartimore shtojnë borxhet”.

Edison Memolla . Tani kur shkon në vendim gjykatë...

Mitat Daja . Ka ndonjë prioritet kjo lista e borxheve në bashki, për shembull?

Edison Memolla . Nga më i vjetri tek më i ri.

Mitat Daja . Prioriteti është nga më i vjetri?

Edison Memolla . Po kështu funksionon, sepse i vjetri ka të drejtën që të kërkojë ardhje, se të hedh në gjyq dhe ta merr me interes gjithë kohën që s'ke paguar.



Mitat Daja . Në fakt duhet të tentohet ulja e borxhit gjithmonë.

Edison Memolla . Të ulet borxhi, duhet të rriten taksat.

Mitat Daja . Rriten taksat, po taksat, po ta shikosh relacionin e taksave, se e kam parë, Jo, jo, kisha vetëm një shpjegim, dhe e mbylla se po t'i shikosh taksat në krahasim, do duket sikur nuk po shkojmë drejt uljes së borxhit. Me këto taksa që janë mbledhur deri tani, do shkojmë drejt shtimit të borxhit, sepse ke shërbime, ke shpenzime korrente, ke shpenzime operative, ke shumë gjëra që ke në buxhet. Edhe këto deri tani, taksat janë në nivel dhe kur kanë ngelur dhe dy muaj ose tre muaj, sa ka ngelur nga...

Edison Memolla . Taksa më e rëndësishme për buxhetin tonë është taksa e ndikimit në infrastrukturë. Nëse do bëhet pjesa e vijës bregdetare, do hapet mundësia që të rikthehet në një zonë elitare dhe ashtu siç duhet...

Mitat Daja . Ne po flasim në këtë moment ku jemi.

Edison Memolla . Meqë jemi në vendin që jemi, edhe atje herë pas here qeveria jep leje dhe ne mund të rikuperojmë taksën. Kështu që ajo është çështje që ne po krijojmë, prandaj edhe ajo rrugë është...

Mitat Daja . Unë do ta propozoj edhe në...

Edison Memolla . Edhe prandaj ujërat e zeza do prapë atje që...

Mitat DajaDhe te buxheti, por duhen ulur shumë shpenzimet dhe me rritur mundësinë për të hequr borxhin, duhet me ulur shpenzimet sidomos shpenzimet që janë operative.

Edison Memolla . Ne jemi ulur thujse në minimumet e gjithë shpenzimeve.

Mukades Gixhari . Keni pyetje tjera për drejtorin e financës jeni dakord, kalojmë pikën tjetër. Faleminderit. Kalojmë në pikën 12, Informacion nga Drejtoria e Politikave Urbane për punën e bërë në drejtim të aplikimeve të lejeve online, projekteve të reja, procesin e legalizimit dhe evidentimin e problemeve të kadastrës dhe pronave. Shqyrtohet i njëjti material i vënë në dispozicion në mbledhjen e datës 19.08.2025. Kemi drejtorin e politikave urbane z. Tomorr Thartori . Përshëndetje!



Tomorr Thartori . Përshëndetje të gjithëve ! Atëherë, Drejtoria e Politikave Urbane përbëhet nga tre sektorë, nga secili sektor, nga data 4.8.2025 ju kemi relatuar, ju kemi dhënë përgjigje të detajuar për çdo proces që kryhet nga zyra. Janë tre faqe t'i lexojmë tek e tek apo doni...?

Mukades Gixhari . Tani për këshilltarët, keni pyetje t'i lexojë?

Hekuran Xhani . Ku hasin vështirësi qytetarët?

Tomorr Thartori . Tek sistemi elektronik për e-lejet. Kemi 86 aplikime nga këto, thotë, 24 janë refuzime, 21 miratime, të tjerat janë në proces shqyrtimi. Aplikimi online është për deklaratë paraprake punimesh, nuk është për projekt të mirëfilltë.

Hekuran Xhani . Qytetarët këtë duan të dinë. Pra, për të ndërtuar një shtëpi sot duhet të fillosh me aplikim online apo me dorëzim të dokumentacionit në bashki?

Tomorr Thartori . Nuk ka fare dorëzim dokumentacioni. Sistemi elektronik është vetëm online.

Hekuran Xhani . Unë, për shembull, do filloj të ndërtoj një shtëpi...

Tomorr Thartori . Për avulli, për çfarë janë pjesë e qytetit, për rrethime, për objekte vetëm online.

Hekuran Xhani . Po për ndërtim ndërtesash?

Tomorr Thartori . Për riparime të thjeshta pastaj është me nenin gjashtë.

Hekuran Xhani . Ore, Kadri Osman Liçini ka për të ndërtuar shtëpi, i shkreti, ka sot pas 30 e ca vitesh ja ka sjellë Zoti mbarë , ku duhet të shkojë?

Tomorr Thartori . Aplikon fillimisht për leje zhvillimi. Për të aplikuar për leje zhvillimi, duhet projekt ide paraprake e projektit.

Edison Memolla . Po kush ia bën? Ai do të dijë ku ë drejtohet.

Tomorr Thartori . Studio, arkitekt, inxhinier privat që bën projektin, që i ka dokumentet, sepse duhet të jenë të licencuar.



Edison Memolla . Atëherë, për të kërkuar një leje ndërtimi, duhet që personi individ të shkojë tek një studio ligjore që i ka të gjitha licencat e duhura, bën një projektim. Atë projektim, projektuesi e aplikon në bashkinë e Rrogozhinës tek e-leje online. Aplikohet, shqyrtohet nga zyra nëse çdo gjë është ok, sipas procedurave ligjore, miratohet; nëse jo, refuzohet, kundrejt një afati 45-ditor. Kështu që gjëja kryesore, do të marrë dokumentacionin, do të shkojë te inxhinieri.

Tomorr Thartori . Është çdo gjë online, nuk ka nevojë fare të vish tek zyra. Aplikohet, fatura e pagesës çohet po online, edhe miratimi del me vulë elektronike, po online.

Hekuran Xhani . E mora përgjigjen. Vazhdojmë pikën tjetër.

Edison Memolla . Pjesa e legalizimeve që është pjesa më... pjesë. Sa aplikime kemi bërë ne si bashki me atë ligjin e ri që ka dalë?

Tomorr Thartori . Kemi bërë dy-tre kërkesa nga 40 emra,

Edison Memolla . Po janë diku prej 120 dosje që janë çuar nga bashkia. Kemi bërë një grup pune që e kemi ngritur nuk e di, kemi ngritur në këshill a kemi ngritur me urdhër të brendshëm, janë dërguar 120 dosje. Realisht presim një mbledhje, dhe duke ditur që dhe qeveria bën këto ndryshimet e veta. Presim të bëjmë një me Ministrin e Pushtetit Vendor që na ka thirrur për këtë pjesë dhe të diskutojmë, t'u japim dhe një përgjigje. Sot që jemi, nuk kemi një përgjigje për t'ju dhënë që po, por ne kemi qenë korrekt ato dosje që kemi çuar, i kemi çuar s'po të them 100%, mund të ketë ndonjë gjë të vogël, por janë 100% ashtu siç i do Kadastra, që të mos ketë që të thotë "të mungon kjo letër", "jo pritje, do ta bësh në këtë mënyrë". Kemi qenë në versionin që Kadastra të mos thotë gjë që e keni bërë gabim, duke qenë ndihmë për qytetarët, dhe i ftoj qytetarët me aq sa mundësi kemi me një grup të vogël prej 4 vetash po të shkosh shtëpi më shtëpi të bësh matje jemi çfarë problemi të ketë ja plotësojmë dosjen.

Gezime Met-hasani . Një procedurë nuk ka dmth? Nuk ka kontrastisht çfarë të ndjekë një që interesohet për këtë për legalizim.

Tomorr Thartori . Kushdo që ka bërë kërkesë, është bërë matje nga ana e specialistëve të bashkisë tani jemi në pritje të përgjigjes.

Edison Memolla . Nëse ju doni të bëni një legalizim për shtëpinë tuaj, po e marr ju personalisht bëni një kërkesë zyrës, drejtuar komisionit që është ngritur për këtë punë. Komisioni e merr në shqyrtim dhe të vjen brenda disa ditësh, vjen të bën matjet, ta plotëson dosjen me ato probleme



që ke, apo bëhet apo s'bëhet, dhe i niset për shqyrtim Kadastrës. Pastaj ne jemi ndihmës, ne jemi ndihmësit tuaj në këtë rast, se kemi vendim është procedurë...

Hekuran Xhani . Ky ligji i legalizimeve ka dalë, mos gaboj, më 2007–2008 fillimisht, edhe të gjithë qytetarët plotësuan dosje të rregullta me matje, në bashkëpunim me pushtetin vendor. Pra, fshatrat mbuloheshin nga komunat dhe topografi os agronomi pothuajse i patën plotësuar të gjitha dokumentacionin e nevojshëm në njësinë administrative–komunë, dhe ishte një zyrë e legalizimeve në qytetin e Kavajës. Dhe kjo zyrë i kishte pothuajse 90% të aplikimeve që kishin bërë qytetarët. Këto dokumentacione ku shkuan? A janë të vlefshme sot? Sepse ka kaluar kohë, edhe i kanë shpenzuar qytetarët, plus mund edhe punë në administratën vendore ndër vite.

Tomorr Thartori . Janë të vlefshme, ndodhen në arkivën e ASHK-së. Mirëpo, për çdo rast legalizimi të ri, nuk merret më për bazë matja që është bërë në 2005-ën kur është hapur ligji i legalizimit.

Indrit Dedej . Jo, të ri thotë për të vjetrin.

Tomorr Thartori . Po pra, për çdo legalizim, për shembull, qa aplikuar në 2005-ën, do të shkojë të bëhet matje sot do verifikohet ka afat tre muaj ASHK-ja që të kthejë përgjigje “po” ose “jo”.

Hekuran Xhani . Ishte sanksionuar me ligj që me ligjin e ndarjes së tokës, zona fushore Luzi Madh e ka 200 metra pra – 100 metra, 120 metra objekt për legalizim dhe 200 metra ku nga zona kodrinore ka pasur ...tani i bie që prapë qytetarët...

Tomorr Thartori . Tek ligji i legalizimit është trefishi i gjurmës së objektit deri në 500 metra.

Hekuran Xhani . Deklarojmë ne se meritojmë çdo qeveri që ka ardhur në pushtet ka thënë “legalizim falas” 30 vjet edhe një shtëpi qytetari shqiptar se ka blerë.

Tomorr Thartori . Është kërkesë e kryeministrit dhe mbyllet në 2029-ën.

Erind Tosku . Një pyetje dhe një propozim, kështu gjërash. Duke qenë se është pikë shumë e rëndësishme nga qytetarët, ju përbëheni nga katër veta për pjesën e madhe. A nuk mund të shtojmë dot një organikë tjetër që ta ketë më të shpejtë dhe t'i ndihmojë më shpejt qytetarët për matjet, për legalizimet, se ju nuk e di, mund të keni një dyndje të madhe.



Tomorr Thartori . Ne jemi ndihmës, procedura është e ASHK-së. Matja bëhet në bashkëpunim me ASHK-në.

Edison Memolla . Nuk është se ne kemi marrë përgjigje për ato 120, dhe ngelëm mbrapa.

Tomorr Thartori . Taksën e ndikimit në infrastrukturë e kemi me vjelë për 84 objekte, shumica janë nga legalizimet, aplikime të reja janë shumë pak për leje ndërtimi. PDV-ja është për rastet e tërmeteve që nuk kanë dokument pronësie, kemi hartuar një PDV me 39 emra presim edhe një me 38 dhe e mbyllim.

Mukades Gixhari . Pyetje tjetër?

Tomorr Thartori . Kërkesa për projekte...?

Indrit Dedej . Çfarë projektesh, do na bësh ndonjë pallat?

Tomorr Thartori . Teorikisht, neve na vjen kërkesa, pastaj bëjmë projektin , atë funksion ka zyra.

Mitat Daja . Kërkesë për projekte i kemi bërë disa herë, ajo është një zonë e gjithë që do projekt, gjithë ajo malësi, sigurisht që rrugët e lagjeve po e po.

Edison Memolla . Një nga projektet që mund të bëjmë tani shpejt është për pjesën e gjimnazit, pjesa e fushës së futbollit për fëmijët që janë aty. E kemi bërë një projekt që bashkë me zyrën është sjellë, bëhet me tapet dhe të jetë...

Silvana Aliu . Shumë mirë, kush po e bën ?

Tomorr Thartori . Zyra.

Silvana Aliu . Nuk ka lidhje me persona të tretë?

Alime Hoxha . Jo, do aplikojmë për financim pastaj, se ju po bëni projektin, po si financim?

Edison Memolla . Nuk ka, po e bëjmë, se është projekt që mund ta mbulojmë me firmat dhe punonjësit e zyrave që mund ta bëjmë pa pagesë këtë projekt dhe e zgjidhim, se është pjesë më shumë ... dhe mendojmë që ta zgjidhim mirë këtë gjë dhe të jetë një gjë për shkollën. Ne kemi



dhe një problem tjetër që unë e kam parë, që është problem për shembull, pjesa e gjimnazit të Gosës që nuk ka palestër, duke parë që gjithë shkollat e reja po shkojnë me palestër. Këto janë gjëra që mendoj se duhen propozuar ndoshta në buxhet, edhe kërkesë për projektim pak, për projektim që ta kërkojmë edhe nga projektuesit që ta bëjmë me financë. Edhe nga nxënësit unë e kam kërkesë nga nxënësit nuk e di, që ma kanë kërkuar pjesën e...

Silvana Aliu . Sepse informacionet janë ndryshe.

Mukades Gixhari . Faleminderit z. Tomorr. Vazhdojmë në pikën 13, informacion mbi punën e bërë nga sektori i pyjeve dhe përmirësimi i shërbimeve dhe veprimtarisë që ofron në këtë fushë. Shqyrtohet i njëjti material që ka qenë në mbledhjes e datës 09.09.2025. Përgjegjësi i pyjeve zoti Artur Kaja. Përsëndetje, zoti Artur!

Artur Kaja . Përsëndetje të gjithëve! Atëherë, në përgjigje të shkresës tuaj numër 3432.prot datë 21.08.2025 informojmë se sektori i pyjeve në bashkinë Rrogozhinë e organizon dhe ndërton punën e tij në bazë të ligjit për pyjet dhe akte të tjera ligjore, nënligjore në funksion të tij. Për vitin 2024–2025 puna e sektorit të pyjeve ka konsistuar në administrimin, mbrojtjen dhe menaxhimin e fondit pyjor e kullosor që ndodhen në territorin e bashkisë Rrogozhinë. Fokusi ka qenë në ruajtjen e qëndrueshmërisë së ekosistemeve natyrore.

Mitat Daja . Artur se ne e kemi përpara materialin vetë, e lexojmë dhe vetë, ju thoni: E keni si detyrë dhe përgjegjësi mbrojtjen e pyjeve nga prerja apo jo?

Artur Kaja . Po.

Mitat Daja . Sa hektarë pyje ka Bashkia Rrogozhinë? Po të bëj një pyetje.

Indrit Dedej . Sa janë prerë thuaji?

Mitat Daja . Përafërsisht. Nuk është puna ta thuash fiks, përafërsisht.

Artur Kaja . Bashkia e Rrogozhinës ka 1800 hektarë.

Mitat Daja . Dhe si është e shpërndarë kjo? Kryeviidh?

Artur Kaja . 74.9 ha Janë në zonën e Bedenit, 90 hektarë, në Spille.



Mitat Daja . Ishte pyetje kështu, sa për informacion. Atëherë, sa rojtare ke gjithsej ti?

Artur Kaja . Atëherë, në organikën e sektorit të pyjeve janë dy inspektorë zone.

Mitat Daja . Jo inspektorë rojtarië, se inspektori ka funksion tjetër.

Artur Kaja . Atëherë rojtare kemi vetëm një në zonën e... në njësinë administrative Lekaj, dhe dy inspektorët që mbulojnë... po janë për mbrojtjen e pyjeve.

Mitat Daja . Ti, domethënë, ruan pyjet tani normalisht duhet të kesh dronë. Po bëj pyetje tjetër prapë, domethënë që dal diku tjetër. Pyje ruhen me dronë tani sepse një rojatar nuk i mbron, nuk i sheh, nuk i shikon pyjet as nga prerja, as nga zjarri; se këtë e kemi parë këtë vit se çfarë ka ndodhur.

Erind Tosku . As Amerika s'ka dron për pyje Mitat.

Mitat Daja . Jo, e di, more burrë, e di që s'ka, se s'jam kaq i painformuar. Jam shumë i informuar. Po bëj një pyetje... pra, pse ju asnjëherë, kur sillet buxheti, nuk sillni në organikën tuaj dhe rojtare pyjesh, ose ku di unë, ose mënyrë tjetër për t'i ruajtur këto pyje që...

Edison Memolla . A po flasim për t'i ulur ato...?

Mitat Daja . Dakord, dakord, po ky informacion është një copy-paste.

Edison Memolla . Se për të futur roje pyjesh ne e dimë që janë ... e dimë çfarë do bëjë rojtari i pyllit. Për mendimin tonë, është më e mirë me një inspektor që të kontrollojë, dhe nëse vendoset, ka të drejtën e gjobës, e ndjekjes.

Mitat Daja . Po zjarrit si ja bën zjarrit ti?

Edison Memolla . Atëherë, në pyje, që ta nisim nga pyjet asnjëherë nuk është nisur gjithmonë ka nisur te zonat që ka pasur njerëz zjarri asnjëherë...

Mitat Daja . Po gjatë verës shtohen punonjësit e pyjeve? Gjatë verës shtohen punonjësit e pyjeve. Dakord në dimër... nuk ka nevojë gjatë verës shtohen?

Edison Memolla . Jo.



Mitat Daja . Atëherë, nuk ka ndonjë vlerë, ne mund ta lexojmë dhe mund ta dëgjojmë që të gjithë, edhe nuk është që fitojmë ndonjë gjë.

Edison Memolla . Propozimi është që të shtojmë personel për...?

Mitat Daja . Po sigurisht. Ai duhet ta bëjë propozim zyra e tyre këtë gjë. Këtë gjë duhet ta kishin pasur bërë, sepse ai thotë: Kam 1000 hektarë pyll aty, ty këtë vit sa të është djegur ? Të është djegur 500 hektarë...? Po prit, kjo nuk është normale edhe të mos merren masa, sepse ajo ndodhi.

Silvana Aliu . Drejtorja juaj e ka në sistemin e rojes... dmth mund të shtojnë roje?

Mitat Daja . Ore, unë të jap një shembull, mund të bëhet, mund të jepen zgjidhje të tjera.

Artur Kaja . Atëherë, ligji për pyjet nr. 57/2020 e parashikon qartë fare që një inspektor pyjesh duhet të ketë deri në 1500 hektarë pyje për t'i mbrojtur.

Mitat Daja . Një inspektor?

Artur Kaja . Një inspektor.

Mitat Daja . Po inspektori çfarë roli ka? Roja apo inspektori ka rol për... për të parë pyllin, është... ka një pemë të sëmurë që mund të bëjë...?

Artur Kaja . Inspektori ka detyrë për mbrojtjen e pyjeve nga prerjet, nga lajmërimi për zjarret, nga çdo lloj veprimtarie që ndodhet në fondin pyjor.

Mitat Daja . 1500 hektarë?

Artur Kaja . Po.

Altin Tosku . Po ku e mbulon dot gjithë zonën?

Artur Kaja . Ai që është vendimi i qeverisë edhe ligji, ... Po të shikosh ligjin 57/2020,

Altin Tosku . Ti pyjoren nuk e ke bllok, që e ke hajde, se ke bllok.



Mitat Daja . E di kush ështëë bukura ? Se unë, kur lexoj buxhetin në fund të vitit, e bukura ështëë që ju i vendosni te buxheti “lopata dhe kazma”. Kjo, kjo më pëlqen më tepër. Ajo më pëlqen më shumë.

Edison Memolla . Ju propozoni ose bëni kërkesën çfarë doni, se unë nuk po ju kuptoj çfarë doni.

Mitat Daja . Po them që të bëhet diçka nuk po them nuk kam lidhje me ty

Edison Memolla . Ne duam që pyjet mos digjen dhe mos priten.

Mitat Daja . Për këtë po flas, të gjejmë një zgjidhje. Sektori,e mendon këtë gjë ne nuk e zgjodhim dot se nuk jemi specialistë.

Artur Kaja . Atëherë, për dhënien në përdorim të pyjeve, ne kemi diskutuar disa herë që duhet me kaluar Këshilli Bashkiak, Këshilli Bashkiak s’ka kaluar asnjëherë këto vitet dy vitet e fundit, kështu që ne s’kemi dhënë asgjë leje, përveç që në 2021-in që kemi dhënë...

Silvana Aliu . Çfarë masash janë marrë nga Drejtoria juaj për rënien e zjarrit të fundit që është...?

Artur Kaja . Atëherë, Drejtoria, puna jonë si inspektorë të pyjeve, ose si inxhinierë të pyjeve që jam unë konkretisht, nuk ështëë në etikën e tij direkt në terren, por në organizimin e punës; që do të thotë: të organizohen njerëzit në grupe-grupe për fikjen e tij. Normalisht edhe në fikje, sepse unë vetë kam marrë pjesë në fikje të zjarrit, edhe sidomos në zonën e Bedenit. Mos kisha qenë, jo për ashtu, zjarri do kishte hyrë në beden.

Silvana Aliu . Grupet vullnetare... Këto janë dhe ato lopatat e kazmat që përdoren.
Artur Kaja . Grupet vullnetare janë të ngritura në çdo njësi administrative dhe në çdo fshat.

Erind Tosku . Një pyetje kisha unë: ju si Drejtori, domethënë, besoj keni lidhjen e ngushtë me Zjarrfikësen, domethënë, Drejtorinë e Shërbimit të Zjarrit. Tani, ju ka sjellë një shkresë, ose keni çuar një shkresë, që: ku janë zonat që ju keni... domethënë, Drejtoria e Zjarrfikjes ka pika të rrezikshme, pika të kuqe, në hartën e pyjeve të Rrogozhinës, që janë problematike; që mund të dalë një zjarr që duhet ndërhyrë, që duhet edhe ju të hapni rrugë, që duhet edhe ju të preni disa pemë që të mos shkaktojnë... ose të bëhet një sistem vargu që të mos hyjë nëpër fshatra ose nëpër qytete. Sepse, me këto zjarret që kanë qenë deri tani, kanë rrezikuar shumë banesa; Sinaballaj kanë qenë shumë afër në pjesën e Vilë Bashtovës Ballaj ka qenë shumë afër, ferrat, toka të



papunuara, qytetarë që janë në emigrim, por nuk pastrojnë tokën, e gjithë këto gjëra. ju keni bërë ndonjë gjë për këtë pjesë?

Artur Kaja . Atëherë, flasim për fondin pyjor. Unë flas për fondin pyjor. Ndërsa në ato që the ti,

Erind Tosku . Se fondi pyjor... në qoftë se po flet për fondin pyjor, dhe kjo do llogaritet tek fondi, që ti do ta çosh tek buxheti.

Artur Kaja . Fondi pyjor nuk është në zjarrin që ra, për shembull, në Ballaj apo diku tjetër. Fondi pyjor ...

Edison Memolla . Pikat kritike tek fondi pyjor a i ke thotë?

Artur Kaja . Po, atëherë, po ta shikosh ...

Erind Tosku . A i keni ardhur në ndihmë zjarrfikëses që zjarrfikësja ta ketë kollaj ndërhyrjen?

Artur Kaja . Ne, çdo vit, nga muaj prill-maj, bëjmë një plan të përbashkët me zjarrfikësen dhe Emergjencën Civile. Bëjmë takime bashkë me zotin Dushku dhe të Emergjencës Civile në çdo fshat, bëjmë takime me kryepjeqtë dhe i lajmërojmë, ose marrim masat për vitet, për periudhën në vazhdim çfarë do bëhet për këto edhe dëgjojmë edhe shqetësimet e atyre, kërkojnë fletpalosje kemi bërë dhe fletpalosje për zjarrin në pyje.

Mitat Daja . Është hapur ndonjë rrugë për të shkuar zjarrfikësja në pyll? Se ka vende ku zjarrfikja nuk shkon dot, sepse zjarrfikësi rrezikon dhe jetën kur ngjitet me terren, jo rrugë është bërë ndonjë plan i tillë nga ju si drejtori pyjor?

Artur Kaja . Ne plane kemi bërë, edhe projektin kemi bërë për hapjen e koridreve.

Mitat Daja . Ku janë këto pse nuk janë zbatuar ?

Artur Kaja . Por sido të flasim zjarrfikësja në pyll nuk shkon dot edhe jo rrugë të hapësh nuk shkon përveç zonës së Spillesë dhe Bedenit që mund t'i afroresh.

Mitat Daja . Hapja e rrugëve bëhet siç e tha dhe kolegu për ndërprerjen e zjarrit nga një bllok në një bllok tjetër.



Artur Kaja . Ato janë hapje koridoresh që ne i bëjmë për të minimizuar zjarrin

Erind Tosku . A kemi marrë një ditë skrepin kemi pikë referimi nga Drejtoria e Zjarrfikjes që thotë zjarrfikësja: “Kjo rrugë duhet të ma hapësh, sepse nuk e kam më të mirë për të aksesuar te zona A, zona B, zona C.” Ka shkuar një ditë skrepi të bëjë atë kërkesë që ka bërë zjarrfikësja ndaj Drejtorisë së pyjeve për të hapur një rrugë?

Edison Memolla . Duke bërë diskutime me drejtorin e zjarrfikëses takimet që kemi bërë ne sezonin e verës ne i dimë pikat kritike, ato që i kemi ne, me mjetet tona dhe hapësirat që mundemi, ne i kemi hapur disa shtigje. Normalisht që do të hapet më shumë, kjo nuk diskutohet. Normalisht që do të ketë dhe mirëkuptimin e atyre qytetarëve tanë, dhe që rrugën ne e kemi zakon që ta ngushtojmë, mos me e hap. Kështu që na duhet një mirëkuptim i të gjithëve në rastet e zjarrit. Ne kemi ngritur grupe vullnetare që nuk kanë lidhje fare; as marrin pagesë, asgjë vijnë atje në zjarr, fikin zjarrin. Kemi vende që ne kemi qenë shumë afër, përveç se në Rrostej kam parë njerëz që kanë hyrë, kanë fikur zjarrin. Kështu që mos presim që kur zjarri të niset e të vijë te shtëpia jonë, t’i kthehemi me fik zjarrin tani, zjarri na dëmton të gjithëve. Mbi 90% këto kanë ardhur nga zjarrvëniet e qytetarëve; jo nga pakujdesia e njerëzve që janë edhe shoqëruar dhe ndjekur penalisht. Kështu që shumica e gjërave vjen po nga dora e njeriut. Nëse ne do zbatojmë atë ligjin që thotë: “Nga kjo datë deri në këtë datë nuk duhet të niset zjarr”, mbi 80% të këtyre zjarreve eliminohen, dhe ne heqim një barrë shumë të madhe që këtë vit nuk ka qenë më shumë se kemi pasur këtë vit zjarre; besoj që edhe Besi do shpëtojë pastaj që ka nisur nga pjesa e Zanbishës ka dalë deri në Rrostej. Kemi pasur ndërhyrje në emergjencë, se na kanë sjellë helikopterin, jo një, por kanë sjellë dhe dy herë pas here, kështu që kjo është një problematikë që duhet ta ndjekim bashkërisht, dhe jam dakord me ju që duhet bërë më shumë.

Hekuran Xhani . Zoti Artur, sistemi i ruajtjes pyjore funksionon, ka roje?

Artur Kaja . Kemi një roje në njësinë administrative Lekaj dhe dy inspektorë zone: njëri mbulon zonën Beden–Spille dhe tjetri mbulon zonën nga Lekaj, kufiri i Lekaj, në Sinaballaj.

Hekuran Xhani . Pra, këto janë, tashi, një pyetje, për një sqarim lidhur me këtë sipërfaqet që janë mbjellë ullishte. Njerëzit i kanë mbjellë, ulla të tilla po bëhen kanë filluar nga 2005 të paktën atje tek unë. Tani, a mund të bëhet diçka që t’i regjistrojnë, sepse ata kanë investuar? Në fund të fundit ata janë të gatshëm me çfarë kam folur unë me paguar dhe një taksë që mund t’i shërbejë.

Edison Memolla . Tashi ka dalë një nismë edhe e qeverisë që thotë “paketa e maleve”, që thuhet: Kush ka, mund të aplikojë, të tregojë investimin, dokumentimin që po i ke bërë ti këto



gjëra, se mund të ketë abuzim që si ta zabtojmë këtë pjesë dhe ta marr unë, apo ta marr X, apo ta marrë Y. Duke bërë këtë dokument shtesë, ne po presim dhe të japim një udhëzim përfundimtar, besoj ka ardhur një dokument dje, voluminoz që duhet lexuar. Dhe është dhënë mundësia që t'i regjistrojmë, t'i bëjmë pronë ato që kanë mbi 10 vjet që i punojnë realisht.

Hekuran Xhani . Kanë dhe më shumë,

Edison Memolla . Në datë 23 unë kam një mbledhje për këtë pjesë, kështu që të marrim...

Silvana Aliu . Atëherë, kemi një ankesë nga banorët e fshatit Spille për dy toka të zabtuara dhe është vënë rrjeta në plazhin tek pishat.

Artur Kaja . Po. Atëherë, unë kam bërë një kontroll të komplet zonës para ca ditësh dhe kam verifikuar. Janë dy para restorantit të Roçit se ka deti si e ka ai, janë dy persona nga Tirana të cilët e kanë rrethuar.

Edison Memolla . A është abuzuar me këtë pjesë apo jo që thotë? Tani merri letrat...IMT-ja, Policia Bashkiake ...

Silvana Aliu . Ne e kemi verifikuar që është në mënyrë të paligjshme.

Artur Kaja . Ato, sipas atyre, unë nuk kam takime me ato, por ato pretendojnë që kanë certifikatë pavarësisht se rrethimi nuk lejohet... Unë e kam bërë disa herë problem këtë gjë...

Edison Memolla . Siç ta dini dhe të gjithë, besoj që e dini më shumë pjesa e pishave, mbi 80% e pishave është me certifikatë se si e kanë, si e kanë marrë.

Altin Tosku . Besoj gjysma janë bllokuar nga prokuroria.

Edison Memolla . Janë bllokuar dhe janë me certifikatë.

Artur Kaja . Ky problemi i Spillesë është ka shkuar në prokurori, ka shkuar në gjykatë, gjykata i ka pezulluar por akoma, siç e dini, ka disa nivele gjykatash sepse...

Silvana Aliu . Në momentin që të japë vendimi gjykata, nuk ka pse rri...

Artur Kaja . Gjykata e Apelit të Durrësit ka vendosur rikthimin në shtet, por ka dhe një Gjykatë



të Lartë që dikush mund ta çojë dhe mund ta fitojë, ose mund edhe s'e fiton... Rrethimi normale që nuk lejohet. Ne, unë, tani do bëj...

Indrit Dedej . Në momentin që shprehet gjykata, është shtet je ti direkt përgjegjësi...

Artur Kaja . Ka dhe shkallë më të larta gjykatë.

Indrit Dedej . Në momentin që ajo fiton, ty ta mori...

Edison Memolla . Është vendim që akoma nik ka marrë formën e prerë në momentin që mer formë të prerë...

Hekuran Xhani . Shprehet këshilli, kryetari, në momentin që çështjet e pronësisë janë gjykatë, vetëm gjykata ...

Indrit Dedej . Turo mua më djeg pak ajo djegia atje lart, se e kam ndjekur vetë kështu me... ke pasur ndonjëherë meqë ti theua jam mbledhur me kryepleq... Ke pasur ndonjëherë ankesë nga kryepleqtë ti, për problematikën për një vatër zjarri, që di unë në dijeninë tënde?

Artur Kaja . Ankesë apo çfarë?

Indrit Dedej . Ankesë... ku di unë. Jo, jo, por meqë është mbledh me kryepleqtë këtë dua, s'dua asgjë.

Artur Kaja . Jo, ne bëjmë takime dhe organizojmë që të krijojmë skuadrat vullnetare në çdo fshat që ato janë.

Indrit Dedej . Po pra, ky kryeplaku këtu dua t'ë dal ke takuar njëherë ti?

Artur Kaja . Me kryepleqtë jemi takuar...

Indrit Dedej . S'ka pasur shqetësim?

Artur Kaja . Jo, shqetësim për çfarë, zjarri nuk është që është i planifikuar.

Indrit Dedej . Është i paralajmëruar zjarri.



Artur Kaja . Zjarri është momental, që dikush...

Indrit Dedej . Zjarri që them unë është i paralajmëruar, me fakte e prova.

Artur Kaja . Zjarri që ka rënë në pisha ka filluar nga lagjja e Skuqeve dhe ka dalë në Sinaballaj.

Indrit Dedej . Zjarri që them unë është i paralajmëruar.

Edison Memolla . Tani për zjarret kemi përgjigje nga Besi.

Indrit Dedej . Po, jo, unë, meqë tha për kryepëqetë për kaq doja . Unë e di, me kryepëlakun që kam unë, që flas unë, ai është ankuar tre-katër herë; as s'e ka bërë dëgjuar asnjë; edhe ka rënë zjarri. Është e treta herë vatër zjarri që bie në të njëjtin vend...

Artur Kaja . Shtyllën elektrike ai duhet të ankohet tek OSHE -ja.

Indrit Dedej . Po ke edhe ti pjesë aty, se pylli që është afër aty është mbi telat; telat e tensionit, që ruhen me VKM të posaçme nga...

Artur Kaja . Atëherë, ata janë në pjesën... jo për të justifikuar që... por këtë ankesë nuk e kam dëgjuar ndonjë herë me thënë të drejtën, hera e parë që po e dëgjoj nga ana juaj.

Besnik Dushku . O Indrit atë ditë ka qenë data 10, edhe fatkeqësisht kemi pasur katër zjarre, në një kohë prej dy orësh.

Indrit Dedej . Zjarri i parë ka qenë i joni.

Besnik Dushku . Zjarri i parë ka qenë në Rrostenj, sa kemi arritur në Rrostenj me dy grupe shërbimi dhe unë krye, jam njoftuar që ke një zjarr masiv në Zanbishë rrezikojnë shtëpitë. Jam nisur nga Rrosteni; sa kam në xhade do tregoj dhe atë rastin e zjarrit; se në çdo zjarr që shkojmë, krahas shuarjes së zjarrit, kemi dhe detyra...

Indrit Dedej . Nuk e ve në dyshim punën tuaj Unë e kisha me Turin meqë tha kam bashkëpunuar me kryepëqetë. Me atë kryepëlakun tim nuk ke bashkëpunuar; ti nuk e njeh s'ma do mendja të kesh takuar ndonjëherë.

Artur Kaja . Ai ka qenë i pranishëm por këtë problem se ka shtruar ndonjëherë.



Indrit Dedej . Tani je i respektuar që të vijë Besi se e zgjasim kot me ty, se do ikim. Jo dhe Besi po nuk ka ardhur ai komandanti i postës është kot. Turo vetëm përmende një kryeplak...

Artur Kaja . Se ka ngritur këtë problem se unë me Besin kam qenë dhe me Tik Lekën ne të tre kemi qenë në takime... nga ju po e dëgjoj nuk po e dëgjoj nga kryeplaku.

Indrit Dedej . Do ta sjell unë kryeplakun ti rrezik se njeh fare.

Mukades Gixhari . Zoti Artur, mos u largo. Kalojmë në pikën 14, të nderuar këshilltarë: analizë nga Drejtoria e të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik, me realizimin e të ardhurave dhe shpenzimet për 9-mujorin 2025. Relaton drejtoresha e të ardhurave dhe zhvillimit ekonomik, zonja Marsida Thartori. Përsëndetje!

Marsida Thartori . Përsëndetje dhe njëherë ! Duke qenë se na është kërkuar të bëjmë një analizë të nëntëmujorit... Për të mos e bërë analizën me shumë fjalë, kam ndërtuar disa grafikë dhe t'i interpretojme dhe t'i shpjegojmë. Në grafikun e parë janë të ardhurat e realizuara për 2025-ën, është plani i 2025-s dhe fakti i 2024-s dhe, siç e shohim, plani i të ardhurave totale për 2025-ën ka qenë 265 milion lekë, realizimi i nëntëmujorit është 131 milion lekë, ndërsa realizimi i nëntëmujorit të 2024-s, e njëjta periudhë, është 128 milion lekë, që jemi në një realizim për të njëjtën periudhë diku te 3.6 milion lekë më tepër. Tek grafiku i dytë kemi marrë disa zëra të ardhurash që janë kryesisht nga taksat, dhe është bërë e njëjta analizë. Është krahasuar me planet, me faktin e të njëjtës periudhë për '24-ën dhe faktin e të njëjtës periudhë për 2025-ën. Shohim që nga taksa e ndërtesës kemi një realizim të ardhurash, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, edhe katër milion lekë më tepër. Për taksën e tokës bujqësore jemi pak a shumë në të njëjtat nivele, ndërsa taksat e tjera kanë rritje, nuk e di nëse e keni me ngjyra; besoj janë të qarta. Plan i është paraqitur me blu, fakti i '25 me të kuqe dhe fakti i '24-ës është me të verdhë. Pastaj është dhe një grafik tjetër që tregon për të ardhurat nga tarifat. Është marrë tarifa e hapësirës publike, është marrë tarifa e pastrimit, gjelbërimit dhe ndriçimit. Tek hapësira publike shohim që të ardhurat, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, janë në ulje. Besoj se kjo ishte e pritshme, siç kemi bërë dhe parashikimin e të ardhurave për 2024-n. Parashikimi i të ardhurave për hapësirën publike ka qenë 38 milion lekë. Për 2025-ën e kemi ulur në 35 milion lekë dhe realizimi i të ardhurave për 2025-ën është në nivel 29 milion lekë. Tarifa e pastrimit: kemi pasur një plan prej 27 milion lekësh kemi një realizim për 2025 16 milion lekësh, krahasuar me 14 milion lekë të të njëjtës periudhë të një viti më parë. Ndërsa grafiku i fundit është shpërndarja e të ardhurave sipas zërave: për të marrë njohuri nga i merr të ardhurat Bashkia Rrogozhinë, kush është taksa që ndikon më shumë në të ardhurat e bashkisë? Dhe, sipas grafikut, me jeshile janë tarifat vendore që zënë rreth 54 milion lekë të të ardhurave totale të nëntëmujorit



të parë. Tek tarifat vendore futet tarifa nga hapësira publike, pastrimi, gjelbërimi, ndriçimi. Gjithashtu, 41 milion lekë zënë të ardhurat nga taksa e pasurisë, që përfshin pasuritë e paluajtshme: ndërtesë, tokë, truall. Të ardhurat nga ndikimi në infrastrukturë janë në nivel 15 milion lekë; taksat e tjera zënë diku te 6 milion; dhe taksat që janë të ndara, që janë nga agjentët që ne marrim, siç është, për shembull, tatim të ardhurat personale janë diku në vlerë 13 milion lekë. Për çdo pyetje...

Mitat Daja . Marsida. Në qoftë se s'ka ndonjë tjetër pyetje ta bëjë. Po, tani unë po shoh... Të ardhurat... Tani fakti flet për qershor, apo jo?

Marsida Thartori . Jo, është nëntëmuji.

Mitat Daja . Nëntëmuji, pra, dhe ne deri në shtator jemi...

Marsida Thartori . Janë të ardhura paraprake deri në momentin që është përgatitur kjo thesari se kishte mbyllur komplet.

Mitat Daja . Po pra deri në shtator, po flasim deri... Shtator.

Marsida Thartori . Edhe shtatori është paraprak, i pambyllur plotësisht, sepse të ardhurat nga thesari...

Mitat Daja . Ne flasim fakti i të ardhurave gjendje sa ke, sa ke marrë ti?

Marsida Thartori . Po sa ka alokuar thesari deri në momentin që është bërë materiali?

Mitat Daja . Dhe i bie që ti të jesh tek 100 milion, apo jo?

Marsida Thartori . 131 milion lekë.

Mitat Daja . 131... Ke planifikuar 300 milion?

Edison Memolla . Kemi kaluar në rekord mbledhje, nuk është se kemi...

Mitat Daja . Ke parashikuar 300 milion të ardhura?

Marsida Thartori . Jo, është parashikuar 265 milion.



Mitat Daja . Se këtu s'thotë 300 prandaj apo jo? 250 është këtu kjo... dakord jam. Po mendon që për tre muaj do mblidhet 50% i tjetër?

Marsida Thartori . Ë tani...

Mitat Daja . 50% i asaj që planifikon, se edhe këto 250 milion, 260 milion nuk janë 100% i të ardhurave.

Marsida Thartori . Prandaj është plan nuk është... është një plan që ti parashikon të vjelësh.

Mitat Daja . Prandaj i thashë dhe drejtorit të financave që me këtë lloj ritmi që ju keni, se ju duhet të bën dhe një analizë pse taksat nuk mblidhen, unë e paguaj taksën, edhe ti e paguan. Kush nuk e paguan?

Marsida Thartori . Ja ta shpjegoj, se është e qartë pyetja që bëtë. Ne vjet kemi realizuar 63% të planit, që ka qenë viti me realizimin më rekord që është bërë ndonjëherë. Këtë vit ne parashikojmë që të kemi një rritje nga plani, krahasuar me vjet, dhe shohim që jemi drejt asaj rruge. Të ardhurat janë në rritje, edhe pse ne dimë, që dimë dhe të kthehemi mbrapsht. Për shembull, për të bërë planifikime për hapësirën publike, ne e dinim që ishim përballë një VKM-je që na sillte ulje të të ardhurave, dhe për ta bërë realiste, ne parashikuam një ulje të të ardhurave, që hapësira publike në buxhetin e të ardhurave tona zë rreth 35% të të ardhurave. Hapësirë publike plazh...

Mitat Daja . Do ta bëj një pyetje e kam mbajtur shënim për ta bërë pyetjen për hapësirën publike. Por ideja është kjo, sepse ju gjithmonë planifikoni, Jo po 0.5...

Marsida Thartori . Të lutem ta mbaroj që të mos e humb fillin e analizës. Ne bëjmë një planifikim për taksën e ndikimit në infrastrukturë, që themi: “Ne parashikojmë që këtë vit të lëshojmë pesë leje ndërtimi.” Po ndodh që, nga ana procedurale, mund të mos lëshohen pesë, lëshohen dy, kjo sjell mungesë në realizim të të ardhurave. Këto tre lejet e ndërtimit që unë kam parashikuar t'i vjel, nuk më realizohen, dhe kjo më sjell këtë boshllëkun që unë nuk kam realizuar të ardhurat aq sa prisja. Kështu që nuk ka vetëm lidhje me mbledhjen e drejtpërdrejtë të taksës së ndërtesës, por janë dhe taksa të tjera që nuk varen nga ne.

Mitat Daja . Po mirë, tani, unë pyetjen që drejtoj gjithmonë edhe unë e bëj çdo vit këtë lloj pyetjeje: në vend që ne të ngrejmë ato një taksë 0.5 apo 2.5, ku e di unë sa...se po t'i flasim me shifra pastaj do ngatërrohem ndoshta. A nuk gjendet, nuk bëhet ndonjë analizë se si mund të



merren taksat ose si mund të vilen taksat më mirë te individët dhe te bizneset? Edhe të ulen taksat, se nëse vilen mirë, s'ke nevojë që t'i rrisësh taksat.

Marsida Thartori . Ja, të shpjegoj nga puna që ne kemi bërë dhe nga disa reforma që kemi bërë brenda zyrës, rezulton që deri në nëntëmuor taksa e ndërtesës është vjelë në 70%, taksa e ndërtesës, taksë ndërtesë pasurie që varet drejtpërdrejt nga ne. Tarifa e pastrimit është vjelë në nivel 58%, që varet drejtpërdrejt nga puna jonë. Pastaj kemi taksën e ndikimit në infrastrukturë, që nuk varet nga ne, dhe kjo mua ma ul përqindjen, sepse...

Mitat Daja . Taksë e kujt nuk varet nga ju?

Marsida Thartori . Ndikimi në infrastrukturë. Kemi të ardhurat personale nuk varen nga ne, normalisht, kjo ma ul mesataren kur të bëj llogaritjen e të ardhurave totale. Të ardhurat personale merren nga Tatimet dhe ne marrim përqindjen tonë.

Mitat Daja . Po mirë, a mund të bësh një ndarje, sa është niveli i të ardhurave që mbledh bashkia, që i përkasin bashkisë dhe që janë drejtpërdrejt të ndikuara nga bashkia? Ti ke bërë këtu tarifat vendore, ti ke bërë...

Marsida Thartori . Po t'i kam sipas klasave...

Mitat Daja . Kjo jeshilja nuk ma mbush mendjen mua, se për arsye sepse kjo është brenda asaj përqindjeje që ke bërë ti, 50%. A kupton?

Marsida Thartori . Tarifat vendore futet, hapësira publike, pastrimi, gjelbërimi, ndriçimi. Ja si i lexoj: gjithë zërat që janë futur është parkimi, tarifat e urbanistikës, karburantet, lejet e transportit ... tarifat rregullatore, tarifat e bujqësisë domethënë kjo futet këtu, tek 54 milionëshi te tarifat.

Mitat Daja . Tek tarifa e ndriçimit—sa është fakti i mbledhur?

Marsida Thartori . Tek tarifa e ndriçimit, fakti i mbledhur është 2 milion lekë.

Mitat Daja . Është normale...?

Marsida Thartori . Planin e ke 3 milion lekë?

Mitat Daja . 3 milion?



Marsida Thartori . Po.

Mitat Daja . Planin total? Dhe deri në fund të vitit?

Marsida Thartori . Dhe është mbledhur në nivel 70%.

Mitat Daja . Po. Më shpjegon pak hapësirat publike: cilat janë hapësirat publike që ju merrni taksa, që paguajnë tarifën e ju tek bashkia?

Marsida Thartori . Hapësira publike është “rëra”.

Mitat Daja . Rëra?

Marsida Thartori . Tarifa e rërës. Po.

Mitat Daja . Po këtë vit ti s’ke pasur “rërë” apo jo?

Edison Memolla . Ka qenë ajo ka qenë... Stacionet e plazhit në Spille, Vilë Bashtovë kanë qenë me kontratat që u kanë mbaruar këtë pjesën pesëvjeçare, dhe këto i kanë paguar. Kanë qenë ato që nuk kanë pasur kontratë pesëvjeçare, që i kanë pasur mbaruar në vitin paraardhës. Kanë qenë disa nga këto tre, katër apo pesë, diçka të tillë që bëjnë një ulje të buxheti ynë. Edhe ne duam ta reflektojmë që bën një ulje që ealisht bëjnë një ulje.

Marsida Thartori . Është bërë një ulje dhe po ta shohësh tek grafiku këtu...është e para hapësira publike që është ulur, edhe plazhi...

Edison Memolla . Hapësira që ne marrim të ardhurat nga hapësira publike është pjesa e vijës bregdetare nuk është se marrim të ardhura... se shumë të pakta janë të ardhurat nëpër zonë.

Marsida Thartori . Janë ulur 6 milion lekë krahasuar me të njëjtën periudhë.

Mitat Daja . Janë ulur për këtë.

Edison Memolla . Janë ulur sepse janë ato me mbarimin e kontratave, ata që i kanë pasur.

Mitat Daja . Dhe këtë vit i bie që të jemi më keq...?



Edison Memolla . Këtë vit pritet që të ketë ndryshim VKM-ja. Unë kam bërë takime të shumta që të ndryshojë VKM-ja, që të jepet mundësia e shfrytëzimit të këtyre hapësirave publike dhe të mos...

Mitat Daja . Sa është ndikimi i tarifës?

Marsida Thartori . 25% të të ardhurave nga...

Mukades Gixhari . z. Hekuran Xhani.

Mitat Daja . Ta, unë mora leje, zysh... Tani, gjithmonë ma ndërprisni kur dua me ta mbaruar idenë. Jam duke debatuar, jam duke diskutuar, ta mbaroj, dhe unë kam shumë respekt për xha Hekrin por...

Hekuran Xhani . Parlamenti ka caktuar dy minuta për çdo temë, kështu që do respektojmë kohën, se i bie të ikim nesër në mëngjes.

Mitat Daja . Na vini kushin që në fillim se kështu...

Alime Hoxha . Nuk ka nevojë për kusht se e ke në rregullore, ti fillon dhe nuk pushon.

Mitat Daja . Po na falni që flas... na falni, ju kërkoj falje që...

Alime Hoxha . Ti po bën muhanet.

Mitat Daja . Urdho, po bëj muhabet unë? Jo, s'po bëj muhabet. Unë po diskutoj me drejtoreshën e taksave, sepse këtu është gjë shumë e rëndësishme.

Hekuran Xhani . Diskuto Mitat se po të presim.

Mitat Daja . Jo, mbarova. Faleminderit Marsida.

Edison Mmeolla . I jemi drejtuar ministrisë për ndryshimin e VKM-së, që ta japim prapë me qera atë kështu që, pa merak ...

Mitat Daja . Të jemi pak më seriozë, unë këtu nuk bëj diskutime për t'u dukur se jam më i mençuri i dynjasë, por ne thjesht jemi përfaqësues të njerëzve që ndoshta na kanë bërë pyetje dhe



ne drejtojmë pyetje. Edhe një gjë që ta kemi parasysh: domethënë, edhe me administratën—ne i kemi miq dhe shokë dhe jemi njerëz që njihen këtu, por në momentin kur fillon abuzimi me pushtetin, këto duhet të jenë armiq të tanë—kushdo qoftë: drejtor apo kryetar apo nënkryetar, apo kushdo qoftë i mundur. Kjo është, kjo duhet të jetë kjo është lëvizja jonë që jemi në këtë këshill. Nuk është ne jemi të gjithë miq dhe shokë. Në momentin që ndodh diçka, jemi armiq—po armiq në këndvështrime, jo armiq njerëzor, kështu që s’ka pse të mërzhitet njeri kur flas, se ne jemi se një 21 vetë...

Hekuran Xhani . Kjo është taksë mbledhëse. Ato për shpërdorime i ka ai... Taksë për...

Mitat Daja . Jo , e ke gabim, sepse mbledhja... Po tani nuk kemi vetëm të ngremë dorën këtu, se do bëjmë dhe ndonjë pyetje.

Mukades Gixhari . z. Mitat të lutem ja kemi dhënë fjalën zotit Xhani.

Silvana Aliu . Edhe ne ja kemi dhënë minutat tona le të flasë Mitati.

Mitat Daja . Taksëmbledhësja është më e rëndësishmja në bashki, se për arsye sepse ajo ose e nderon bashkinë, ose e falimenton; edhe ne duhet të diskutojmë për këtë punë se s’bën, edhe s’ka ndonjë gjë të keqe këtu. Taksëmbledhja është mikesha jonë, është miku ynë. S’ka lidhje fare—as po e “vrasim”, as po e “dënojmë”.

Mukades Gixhari . Zoti Mitat të lutem, të lutem...Të lutem! Respekt për kolegun. Vazhdo z. Hekuran

Hekuran Xhani . O Mitat ndjesë se po krijojmë përplasje të dy. Problemi është këtu që të diskutojmë me mirëkuptim, njëri me tjetrin edhe mos harxhojmë kohën kot për pyetje. Kjo vajza për mua është vajzë e re, një kuadro e re në administratë, dëshiroj suksese asaj. Më qartë, më bukur u bë sa u bëmë ne këtu në këshill, s’kam parë një raportim si ky. Unë e falënderoj për punën. Llogari keni të drejtë dhe kam të drejtë t’i kërkoj edhe unë. Kjo këtu raporton: taksat janë në trendin e rritjes pra, kjo nuk ka ... nëse kjo do kishte ulje, kundërshtar do më kishte mua ndërsa kjo, në 2024, ka mbledhur 150 milion, edhe këtë vit ka mbledhur 110 milion... Kjo, përplasjen e parë do e kishte... Kjo ka mbledhur 124 milion për p-mujorin e 2024-s nga 131 thotë për 2025... Çfarë t’i them unë kësaj? Edhe kur të punojë mirë kjo, t’i them... Kaq ka xhaji... Edhe njëherë të falënderoj për përkushtimin.

Mitat Daja . Po e mië po e bëmë kështu ne faleminderit të gjithëve, dhe ikim e bëjmë kështu s’është problem.



Erind Tosku . Atëherë, unë kam një pyetje... Deri tani, në 2025-ën, kemi rritje të mbledhjes së taksave, të të ardhurave, gjëra të tjera. Normalisht trendi i 2026-ës me ndryshimet e VKM-ve të qeverisë ka dhe luhate rritje, ulje, e gjëra të tjera. Keni një farë plani që këto taksa mos të bien shumë, edhe të na ndikojnë tek pjesa e borxhit edhe tek pjesa e investimeve që kemi pra, duke parë trendin e më parë u tha hapësira publike, “rëra”, u hoq nga qytetarët, mbaroi kontrata e... gjëra të tjera. Tani jemi në fokusin që e dimë që do na ulen taksat e vjetra. Tani, kemi bërë një plan masash që mos na ulët... edhe të na rritet borxhi, të na rriten detyrimet... para investimeve që kemi për të bërë shkollat?

Mitat Daja . Nuk e doje nga unë, e doje nga Erindi, kjo është. Faleminderit, Erind që bërë pyetjen që doja të bëja

Erind Tosku . Në qoftë se po shikoje ngjyrën jeshile dhe s’po e dije se çfarë ishte, po e konçizoj unë më kollaj që ta sqaroj.

Mitat Daja . Jo, jo, je në rregull, po them...

Erind Tosku . Pikërisht pra, po ti po merresh me ngjyrat e grafikut, unë po i them pyetjen taman. Pra, kemi fokusuar ku... borxhi ose taksat mos jenë kaq në rënie këtë doja të sqaroja.

Marsida Thartori . Ok, faleminderit, përgjatë 2025-s ne e kishim të pritshme situatën nga “rëra”, e dinim që na priste një vit pak më i vështirë dhe nuk u fokusuam tek tarifat; u fokusuam te taksat. Bëmë një punë në zyrë dhe kërkuam që t’i mëshonim taksave të pasurive të paluajtshme, dhe aty kemi realizim shumë të mirë të të ardhurave, ka tregues që mund të bëjmë dhe më mirë, por që jemi drejt këtij fokusi. Gjithashtu, në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve, Drejtorinë e Urbanistikës, me mbështetjen edhe të Kryetarit, ne po llojmë që të kemi një VKM më të përshtatshme për plazhet tona. Jemi drejtuar me shkresa Ministrisë së Turizmit, Agjencisë Kombëtare të Bregdetit, në mënyrë që ne të na jepet një mundësi ta shfrytëzojmë këtë hapësirën publike që mund të ngelë e paprekur, që kjo do të përkthehet në të ardhura më të larta për ne. Gjithashtu, një tregues tjetër që mund të rrisë të ardhurat është ndikimi në infrastrukturë edhe këtu mendoj që po llojmë dhe po bëjmë punën e duhur, që domethënë ta diversifikojmë buxhetin mos të ngelem në dy zëra, por që nëse njëri na ulët, ta peshojë tjetri, këtë po kërkojmë të bëjmë.

Mukades Gixhari . Ndonjë gjë tjetër? Atëherë ta falenderojmë Marsidën. Vazhdojmë me rendin e ditës, pika 15. Informacion... Marsida të të lutem, mos u largoni. Informacion nga Drejtoria e



Bujqësisë, mbi masat e marra për pastrimin e kanaleve të para, të dyta dhe të treta dhe përgatitjen e tyre për sezonin e dimrit. Relaton drejtori i Bujqësisë, zoti Elton Xhani. Përshëndetje.

Elton Xhani . Përshëndetje të gjithëve. Për masat e marra për pastrimin e kanaleve të para, të dyta dhe të treta, dhe për sezonin e dimrit, kam të gjitha të paraqitura edhe me numër pasurie, edhe me hartë, edhe me gjatësi sa janë pastruar. Në qoftë se doni, që t’jua lexoj me radhë.

Mukades Gixhari . E keni materialin, e drejtorit të bujqësisë?

Elton Xhani . Janë të gjitha të paraqitura me grafikë me harta.

Erind Tosku . Çfarë është duke bërë tani, domethënë, ku jemi duke punuar aktualisht?

Elton Xhani . Tani është po në njësinë Lekaj, është një kanal që është tepër është shumë problematik për zonën e Lekajt dhe Luzit. Përfundojmë atë, pastaj do kalojmë në njësinë Gosë, edhe në Rrogozhinë, më tej...

Mukades Gixhari . Pyetje tjetër?

Indrit Dedej . Në, Sinaballaj nuk pashë fare asnjë lloj flete unë, asnjë lloj metri kanal s’ke hapur në Sinaballaj, të gjithë komunat i kishe prekur nga një çikë kurse në Sinaballaj fare.

Elton Xhani . E para kanali i parë që është bërë me skrepin e ri është kanali i Zogut...

Indrit Dedej . Kanali i Zogut është tek “Shimtë” jo në Sinaballaj.

Elton Xhani . Duke qenë se kemi përfunduar njësinë Lekaj gati të gjithën fare...

Indrit Dedej . Njësia Administrative Sinaballaj s’ka asnjë emërtim fare, për njësinë Sinaballaj pritet gjatë muajve në vijim të pastrohet dhe përroi se i kemi dërguar shkresë Bordit të Kullimit për ndihmë për skrepin, krahëgjatë edhe ata po presin.

Edison Memolla . Është problematika më e madhe, kanali më i madh mjetet që kemi nuk...

Indrit Dedej . Unë duhet të iki kryetar, po doja për atë kanalin që më lavdërove, duhet kështu... po më dha leje kryetari ta them...



Edison Memolla . Ajo nuk është investim që e bën Bashkia jam i gatshëm që aty të bëhet më e mira nëse ka gabime, hajde bashkë ta ngremë zërin, sepse ajo është një gjë që bëhet sot për 30 vjet.

Indrit Dedej . Punimet janë bërë cilësi jo e...

Edison Memolla . Këtë nuk e caktoj dot unë, se s'jam specialist.

Indrit Dedej . Po, por nuk të përket ty se ndoshta investimet i bëjnë ato andej...

Edison Memolla . Jo, po nuk e lë unë, se e kam prioritet bashkie, unë aty e kam shtëpinë çdo mëngjes aty shkoj.

Indrit Dedej . Kryetar cilësinë ata e kanë për faqe të zezë, së dyti, pastaj, pse mos bësh se kanali ka gati 1 metër, 2 metra...

Edison Memolla . Ka 6 metra.

Indrit Dedej . Që ka kështu të vetën majtas, djathtas?

Edison Memolla . Po të shikosh, po të shikosh, ti e ke parë mirë...

Indrit Dedej . Jo, jo po them nga buza e kanalit?

Edison Memolla . Po pra buza e kanalit 6 metra. Po të shikosh, nga ana e sipërme e kanalit, te ura e kanalit, është hapur rruga totalisht. E kemi hapur të gjithë, edhe aty mendojmë që të gjithë lagjet që kanë...

Indrit Dedej . Ta bësh trotuar?

Edison Memolla . Para se të bëjnë trotuarin, do të thotë: ujërat e zeza... sepse gjithë lagjet atje është problematikë, e kemi bërë planin e punës, do e nisim. Sa të shkojë kjo t'i heqim ato tubat që ...

Indrit Dedej . Dhe pikë më të dobët që ke, gabimi më i madh fatal është që të gjithë ujërat e zeza derdhen në kanal.



Edison Memolla . Po, pra këtë jemi duke bërë, ta heqim.

Indrit Dedej . Keni bërë punimin, edhe kemi lënë tubën... kjo ështëkjo është e turpshme të mbyllet urgjentisht, sepse është e turpshme.

Edison Memolla . Ikin këto që po bëjnë punën, dhe me mjetet tona, bashkërisht me fshatarët, me qytetarët në zonë, sepse i kemi çuar shkresë për ujërat e zeza. Materialet i kemi, kështu që vetëm...

Elton Xhani . Për 320 metra që është ajo, në bashkëpunim me “Valin”, kemi qenë dhe në terren, do shkojë skrepi...

Edison Memolla . Do sistemojmë do ngelë e hapur gjithë ajo shëtitore.

Indrit Dedej . Ishalla edhe trotuar por edhe për shëtitore se është shumë bukur. Ndërsa ujërat e zeza mos i toleroni kurrë që të derdhen në kanal sepse unë i kam parë çdo punim kanë lënë tuba edhe i derdhin, tani ku është kontrolli i tyre nuk duhet t'i lejojmë, ujërat e bardha le të dalin por ujërat e zeza jo. Nuk duhet t'i lesh fare është bërë projekti është bërë betonizimi, ose një plep kam parë një plep unë atje në mes të kanalit, po pse të dhimbset plepi ty?! Skrepi, hiqe dhe të sistemohet kanali , kështu që drejtoresha e punëve publike zëre se nuk ka bërë asgjë nëse nuk ka shkukur plepin.

Elton Xhani . Plep në mes të kanalit nuk e ka drejtoresha e ka bordi i kullimit kështu që ...

Indrit Dedej . Kaloje sa adnej këtej , a the e ka drejtoresha?

Hekuran Xhani . Tashi, lidhur me raportimin përsa i përket pastrimit të kanalit. mirëmbajtjes ka ndryshuar për mirë jo për të bërë qejfin por kur bëhet puna flet vetë puna. Kështu që flet puna, dhe ka ndryshuar për mua në zonën që unë mbuloj. Tani, unë kam një kërkesë përfitoj nga rasti që është dhe kryetari meqë në fshatin Luz është bërë goxha punë në të gjitha anët si në sistemin e rrugëve dhe në sistemin e ndriçimit. Ka ngelur z. Kryetar edhe 500 m rruga e varrezave, rruga e varrezave është në gjendje të mjerueshme edhe pak e ngushtë... se dhe atje do shkojnë të gjithë ishalla do bëhet e mundur ...

Edison Memolla . Ne kemi bërë dhe bashkëpunim...

Hekuran Xhani . Të marri përsipër ta fitojë ky dhe që të futet në buxhet në rast se do ketë mundësi.



Mitat Daja . Meqë po bëhet me lutje ka 200 m rrugë për të asfaltuar tek lagjja ime.

Edison Memolla . Po thotë tek varrezat o Miat jo tek shtëpia e vet.

Mitat Daja . Ne po nuk menduam njëherë për të gjallët të vdekurit do i çojmë sido që të jetë puna, të gjallët njëherë përpara.

Besnike Coraj . Kryetar e njëjta gjë si z. Xhani edhe në Gosë ajo rruga e varrezave është shumë e shkurtër ...

Edison Memolla . E kam parasysh është as 200 metra, e kam parë kur bie shi ...

Mitat Daja . Pyetja që kam për Eltonin: këto të gjitha punimet që janë bërë i ke paraqitur bukur, po a ka ndonjë raport të shpenzimeve që janë bërë të këtyre punimeve dhe a kanë qenë të parashikuar në buxhetin e vitit 2025? Apo ju i keni bërë sepse kam ardhur unë kam kërkuar, ka ardhur dikush tjetër... Ka ndonjë raport të shpenzimeve të këtyre punimeve që janë bërë?

Edison Memolla . Ka qenë një një plan pune i bërë nga Drejtori...

Mitat Daja . Po, duhej të kishit sjellë dhe një raport shpenzimesh: sa naftë ka harxhuar, sa orë ka harxhuar, sa punëtorë kanë shkuar, kush ka qenë... Pastaj edhe pyetje tjetër janë bërë me mjetet e Bashkisë janë bërë me mjete...?

Edison Memolla . Atëherë, nuk është bërë asnjë tenderim për pjesën e pastrimit të kanaleve nga blerja e skrepit që kemi pasur, ka qenë punëtorja dhe mirëmbajtja e skrepit.

Mitat Daja . Shpenzimet janë bërë nga Drejtoria e Bujqësisë?

Edison Memolla . Nga Drejtoria e Bujqësisë, në...

Mitat Daja . Po, duhet të kishe paraqitur dhe një raport kështu shpenzimesh këtu, me këtë. Dakord, jemi të gjithë dakord që është bërë shumë punë siç tha dhe xha Hekri.

Edison Memolla . Ka pasur zëra në vitet e mëparshme ka pasur zëra për të bërë tenderime ne e kemi hequr atë zë me blerjen e mjetit, që e kthejmë bëjmë më shumë...

Mitat Daja . Dakord, po, është shpenzuar 2 litra në naftë, është shpenzuar 15 ditë pune, ka një...



Kjo duhej të ishte bërë duhej të ishte bërë, këtë kisha.

Mukades Gixhari . Vazhdojmë me pikën tjetër. Shqyrtimi i kërkesës së anëtares së Këshillit Bashkiak, znj. Silvana Aliu. Kemi një kërkesë nga këshilltarja znj Silvana Aliu besoj se e keni lexuar të gjithë, por për më tepër do na relatoi vetë këshilltarja. Për sa i përket njërës prej pikëve të kërkesës, keni thirrur shefin e MSH-së, gjithashtu kemi përfaqësues edhe të Policisë së Shtetit.

Silvana Aliu . Atëherë, duke qenë se unë dakord, informacionin nga ju e kemi marrë; më shumë e kemi dashur nga Policia e Shtetit. Policia e Shtetit nuk është e pranishme kështu që të shtyhet për mbledhjen tjetër.

Edison Memolla . Për të gjithë pikat apo vetëm policia e shtetit?

Indrit Dedej . Tjetër, Beso ti na jep një raport çfarë ke mbajtur për zjarrin.

Silvana Aliu . Më shumë duam të dimë çfarë masash janë marrë nga policia e shtetit jo nga...

Mukades Gixhari . Dmth me MZSH-në jemi në rregull sepse i ka dhënë informacionet. Atëherë kalojmë në pikën tjetër, në pikën 17 është kërkesa nga poeti, zoti. Hekuran Dedej.

Silvana Aliu . Ej, prit, se ke komisione të tjera, ke atë ngritjen e komisioneve.

Mukades Gixhari . Domethënë kërkesën tënde?

Silvana Aliu . Po, ke ngritjen e komisioneve.

Mukades Gixhari . Vazhdojmë me pikën pesë, te kërkesa e zonjës Silvana: ngritja e një komisioni hetimor te zyra e punëve publike për verifikimin e punëve publike dhe transparencën ndaj qytetarëve, të bazuar në ligjin 139/2015, i ndryshuar, për vetëqeverisjen vendore.

Edison Memolla . Më teket mua të ngre komision, çfarë arsyes ka ky komision, që të japim përgjigje.

Indrit Dedej . Po nuk kemi dhe kolegë të tjerë këtu ...

Mukades Gixhari . Kemi gjithë drejtorët këtu.



Hekuran Xhani . Ky kryetare ta jap unë përgjigjen, meqë kjo kërkesë është bërë nga kryetarja e grupit të këshilltarëve të opozitës, kjo e ka shkruar pak keq “Komision hetimor”, se ne s’jemi hetuesi, komision i verifikimit të shpenzimeve që janë bërë, punimeve që janë bërë, kaq... Këshilli do një informacion dhe mund të bëjë transparencë lidhur me drejtorët...

Edison Memolla . Keni kërkesë apo ngritje se tani po ndryshon, ndryshojnë shumë...

Indrit Dedej . Ne kemi ngritje...

Hekuran Xhani . Komision verifikimesh si të duash, sqarimi, transparence...komision për transparencë për shpenzime....

Edison Memolla . Dakord e kuptova nga nesër të gjithë këto komisione që ju kërkoni nga nesër ne ju ftojme në bashki, kush ka dëshirë që t’i verifikojmë këto gjëra...

Indrit Dedej . Jo jo plus minus opozitë sa na takon ne.

Hekuran Xhani . Po ngrejmë një komision jepja opozitës dy nga opozita një nga ... dhe verifikojmë bëjmë transparencë atje.

Mukades Gixhari . Z. Indrit Dedej është kërkesa juaj mund të na shpjegosh për pikën 5 bëhet fjalë...

Indrit Dedej . Ne kemi të ngrejmë një komision për...

Edison Memolla . Për verifikim ?

Indrit Dedej . Po punën publike, ku janë shpenzuar, çfarë janë shpenzuar, çfarë është bërë, çfarë s’është bërë...

Edison Memolla . Ju ftojme që nesër hajdeni në bashki, ngrejmë bashkërisht...

Indrit Dedej . Jo e ngrejmë ne.

Edison Memolla . Po pra ngrejeni ju, ju japim ne.

Indrit Dedej . Ne vijmë pastaj trokasim tek ju.



Hekuran Xhani . Ne duam të ngrejmë një grup, zoti Kryetar, të ngrejmë një grup këtu prej tre vetësh .

Alime Hoxha . Nuk keni punë me kryetarin.

Hekuran Xhani . Unë propozoj kryetar komisioni nëse i takon opozitës z. Indrit Dedej.

Edison Memolla . Po do parë ligjërisht a lejohet apo jo? Uleni, shikojeni dhe e bëjmë komisionin.

Indrit Dedej . E kemi bërë dhe me Drejtorin e Bujqësisë...

Alime Hoxha . Kush ju tha që lejohet? Tani ju lutem që komisioni që komisioni të ngrihet, duhet të marrë miratimin e Prefekturës. Ju do ta ngriini komisionin, ta çoni në Prefekturë; nëse Prefektura jua miraton...

Silvana Aliu . Po ti ngrije; në qoftë se shkon...

Alime Hoxha . Ti ngreje nuk ju ndalon kryetari për të ngritur komisionin, tani nëse keni pyetje për kryetarin, komisioni është i këshillit.

Indrit Dedej . Ne kemi të drejtë si këshill bashkiak të hetojë çdo lloj zyre të drejtorisë së bashkisë.

Mitat Daja . Po mirë ja ku është Visi jep një përgjigje të kësaj a është kështu apo jo?

Edison Memolla . Tani jemi të gatshëm t'jua e lëmë dhe komisionin nuk ka ndonjë gjë për të fshehur, ju ftojme, nëse doni verifikim që nesër jua japim dokumentacioni.

Hekuran Xhani . Drejtoria e Bujqësisë ka 100 milion për mirëmbajtjen e kanaleve kulluese, ky thotë, ku i ka shpenzuar.

Edison Memolla . O xha Hekri po ngre një komision, çfarë specialisti ke ti për të verifikuar këtë komision. Tani të ngremë një komision ta ngremë taman si duhet jo me ngritur se kam unë qejf me ngritur komisionin.

Hekuran Xhani . Ky është komision këshilli.



Edison Memolla . Kush është specialisti i ekonomisë?

Indrit Dedej . Ta jep të drejtën ligji që ne kemi të drejtë të ngremë komision ...

Edison Memolla . Ke të drejtë ta hedhësh në votim komisionin nuk e ngre se e do ti.

Indrit Dedej . Pastaj po e votj këshilli, pse e bëni të madhe ju ne kemi bërë komision tek ai, kemi bërë tek ti ne?

Edison Memolla . Bëjeni kur të jetë verifikuar 100 % nuk ka asnjë lloj problemi.

Mukades Gixhari . Pikën tjetër e doni për herën tjetër?

Edison Memolla . Këtë raport për rrugën e doni...

Indrit Dedej . Që të vijnë dhe ato tjerët këshilltarët tjerë

Mukades Gixhari . Po ky raporti mbi tenderin e rrugës Thartor - Rrostej të shumë...

Edison Memolla . Ti e ke shkruar atë Indrit ...?

Indrit Dedej . Po mirë aq shkollë kam unë ... këshiltari është vullnetar.

Edison Memolla . Kështu do bëni verifikim ju?

Indrit Dedej . Unë e kam shkruar duke ecur në makinë?

Silvana Aliu . Sa gabime keni bërë ju tek buxheti nuk ju lexonin fjalët.

Edison Memolla . Nga projekt vendim i bërë nga verifikimi që është bërë preventivi është realizuar me të gjithë zërat... me foto , normalisht duhet me bërë gjithë rrugën është 24 km e gjatë në të dy krahët. Aq fond sa është me këto zëra atje ka dal shumë punë pa planifikuar.

Tomorr Thartori . Ne jemi në procedurë kualidimi do caktohet kulidatori...

Edison Memolla . Ne kemi pasur dhe një takim me anëtarin e Këshillit që ka kërkuar si pjesë, si i asaj zone që të rishikohet për vitin tjetër diçka e tillë. Ne jemi të gatshëm që, buxhet, ta



shikojmë një çik më mirë, sepse në disa mslore, me të vërtetë, ka të drejtë që...

Indrit Dedej . Nuk shkojmë Po nuk shkojmë... e ka nis mbrapsht, në vend që ta nisi nga poshtë e ka nisur nga lart. Ideja është këtu: sa kohë kemi ne që ta parashtrojmë këto dy gjëra që kanë ngelur.

Edison Memolla . Parashtroji për vitin tjetër se për këtë vit nuk bën dot gjë.

Indrit Dedej . Se dy vjet na shkoi ne edhe dy vjet të tjera bëhet në 20230. Tani do ta planifikosh tek buxheti, se po nuk e planifikove...

Edison Memolla . Nëse ju bëni kërkesë dhe e keni kërkesë e planifikojmë. A e ke kërkesë?

Indrit Dedej . Kërkesën do e bëjmë ne se do shohim se ku ka ngecur...

Tomorr Thartori . Rruga ka kosto shumë të lartë. Sa është mundësia me investuar atje?

Indrit Dedej . O Tom, pak a shumë ti je në dijeni.

Hekuran Xhani . Ajo rrugë është planifikuar 60 milion lekë të vjetër?

Edison Memolla . As 60 se 54 ka hyrë.

Hekuran Xhani . Tani ju do bëni rikondicionin e rrugës, duhen edhe 120. Buxheti i bashkisë nuk ka mundësi për 2026-ën 120, a mund të hedhim 30–40 ta shtojmë brenda mundësisë së buxhetit këtë qëllim ka Indriti.

Tomorr Thartori . Çfarë punimesh duhet të bëhen? Ne bëjmë projektin nuk bëjmë kërkesa.

Hekuran Xhani . Projektin se kërkesën po e bën ky.

Indrit Dedej . Në qoftë se me çmimin bëjmë kaq, po të shtojmë dhe 20 milion bëjmë dhe kaq më kupton si zë shtesë.

Edison Memolla . Duke ditur që është një rrugë që ka problematika dhe është rrugë që do punë normalisht, që është me e zbukuruar ne e dimë se çfarë pune duhet me e bërë. Duke bërë të paktën ato pikat kritike siç ka thënë edhe të bëjmë me pjesën më të rërë bituminoze.



Tomorr Thartori . Teorikisht parashikojmë vetëm blerje rëre bituminoze.

Indrit Dedej . Sepse e ka dhe një shans, ajo e ka stabilizantin në vend.

Hekuran Xhani . Fondi i Zhvillimit meqë ajo është një zonë turistike andej sipër zonë...

Tomorr Thartori . Fondi i Zhvillimeve e ka me kërkesë. Interes i shumë i pakët.

Indrit Dedej . Fondi i Zhvillimi të bëhet të kalojë këtu e të dalë në Pezë.

Edison Memolla . Fondi Shqiptar i Zhvillimit hap aplikime, por nuk ka hapur për këto, quhen “rrugë të bardha” nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit projekt “Rrugë të Bardha”. Këto dy vitet e fundit nuk ka hapur thirrje për këtë pjesë, në momentin që do hapet, ne normalisht që do aplikojmë. Sepse quhen rrugë të bardha, dhe ato e bëjnë vetëm me zhavorrim dhe tombinot që të kalojë nga një krah në krahun tjetër.

Indrit Dedej . Patjetër duke u konsultuar me Tomin, Tomi më tha që se tashi aq mundësi sa është bërë, ç’është bërë—nuk do i hyjmë asaj “valleje”. Që ne nuk po duam asfalt, ne nuk po duam drita edhe dy tuba...

Tomorr Thartori . Kanalet anësore kanë kosto.

Indrit Dedej . Kanalet anësore pak a shumë janë bërë.

Edison Memolla . Nuk do japim llogarinë tani do bëhet një shumë, shuma x që ne me Drejtorinë e Financës, ne kemi mundësi që ta shpëtojmë kaq, sa pak a shumë sa ç’është. Tani, kjo shumë që bën do e shpërndajmë në ato punë kritike që ato do jenë, atje.

Alime Hoxha . Sa keni shumën sa punime janë bërë me këtë shumë?

Indrit Dedej . Është bërë kontrolli?

Tomorr Thartori . Bëhet kolaudimi ne kemi marrjen në dorëzim jemi të fundit.

Indrit Dedej . Të jap unë dy tre pika që nuk i kanë bërë fare.

Mitat Daja . Kjo pyetje është edhe për Tomin dhe për Drejtorinë e Bujqësisë, se tani po ofrohet



dhe vakti i këtyre vjeljes së ullinjve. Keni planifikuar se njerëzit shkojnë edhe marrin prodhimet si do ja bëjnë? Sepse janë taksapagues: dikush paguan, dikush nuk paguan, por quhen taksapagues dhe janë në përgjegjësinë e juaj. Keni menduar ndonjë gjë që të përdorni mjetet e bashkisë se s'po thotë njeri tani “me bë tender” përdorni mjetet e bashkisë, se keni... Keni dy skrepa të bashkia—sektorët bashkëpunojmë me njëri-tjetrin...

Edison Memolla . Po të shpjegoj diçka me pjesën, se kjo është temë e ngritur, e drejtë. Në këtë njëjtën histori bëjmë dhe pjesën ku bëhet korrja e grurit Sepse ka zona që kanë nevojë ti e bën sot bie një shi edhe e heq nesër. Ne kemi qenë gjithmonë në kontakt edhe me banorët, dhe i ftoj banorët ku kanë pamundësi që ne e vendosim atë skrepin me rrota, që të lëvizë gjithandej, që të bëhen të kalueshme.

Mitat Daja . Po të bëhet një planifikim i mirë që tani, ndërmjet sektorëve realizohet diçka, dhe njerëzve t'ua lehtësojmë se kjo është puna jonë kryesore, lehtësoju njerëzve punën apo jo Tom?

Indrit Dedej . Tashi, nga Rrosteni në Thartor skrepi vetëm një kalim do...Ai s'po do as kanal, asgjë ,se është vend i qëndrueshëm.

Mitat Daja . Tani, se me telefonata s'bëhet kjo punë...

Indrit Dedej . Sa u dogjën pemët atje, filluan me shkuar makinat.

Edison Memolla . Ne jemi dakord, hajde t'i marrim propozimet t'i hedhim në letër.

Indrit Dedej . Jo meqë po thua për skrepin... Po, kjo është logjike: domethënë drejtoresha e mirëmbajtjes e di ku i ka një xhiro tek.

Edison Memolla . Tani, që të bëjë një xhiro skrepi ky me rrota që kemi nuk bën xhiro, se nuk bën asnjë punë, duhet skrep si quhen ato...

Indrit Dedej . A ke një të madh ti? Çfarë ke ti?

Edison Memolla . Nuk ka noçkë përpara.

Mitat Daja . Ore, aq sa është e mundur me bërë.

Edison Memolla . Çdo punë do atë mjetin e vet.



Indrit Dedej . Ka rënë një pemë e madhe aty ka bllokuar rrugën kaq, pse dhe atë nuk mund të bëjë ai.

Edison Memolla . Çfarë janë punë... besoj që kemi qenë aq të mirëkuptueshëm sa jemi dakord.

Indrit Dedej . Unë shkoj me fuoristradë, shkoj deri afër Thartorit, ka rënë një pemë gjigandeë kap skrepi hapet rruga lidhen fshatrat, vjen zjarrfikësja nuk erdhi zjarrfikësja për hiç gjë.

Edison Memolla . Tashi, unë këtë pemën nuk e di ku është, këtu ka një pemë tani, kjo pema më thuaj ku është nesër të çoj skrepin...

Indrit Dedej . Po e di gjithë dynjaja, i ra goja atyre lidhja e fshatrave.

Edison Memolla . Po lidhja e fshatrave nuk është një pemë.

Indrit Dedej . Nga firma tek çezmja mori burri i huaj privat e ka hapur e ka çuar deri tek kisha e di ku është kisha në Thartor?

Edison Memolla . E di se kam qenë.

Indrit Dedej . Punë një dite e hapi ai shkoi atje, tre orë punë u lidheme Rrostenin dhe nuk u digjte. Ai që ka bërë rrugën në Rrostenj 1 milion lekë naftë ka harxhuar. Hajde t'i shohim rrugët bashkë ti si inxhinier, t'i nxjerr unë ty problematikat. Unë them me 10 litra naftë.

Mitat Daja . Dua një përgjigje: bëhet, s'bëhet? Urbanistika dhe Drejtoria e Bujqësisë: a mund të planifikoni ju një rregullim, një lehtësim punëve? Dua një përgjigje: po, ose jo? Urdhëro?

Tomorr Thartori . Po.

Mitat Daja . Mirë, kur të kemi mbledhjen tjetër na thoni se si keni menduar që të bëni këtë punë.
Edison Memolla . Është shumë e thjeshtë: na jepni pikat ku ju i dini dhe ne të bëjmë një plan pune të përbashkët.

Mitat Daja . Po, dakord po jo se ai ka nevojë për ta sqaruar unë po të jap unë “indicie” se ku të shkosh se Tomorri është dhe i zonës. Po, dëgjo... unë nuk bëj kërkesë individuale, në këtë rast po ta bëj kërkesën publike ju, si Drejtori Bujqësie, që keni përgjegjësi për të vjelë ata që janë atje që t'i ndihmoni ata njerëz keni të bëni të hartoheni një plan. Edhe ndoshta mund të mos duhen



shumë shpenzime mund të duhen shumë pak shpenzime dhe lodhemi kot po ama duhet...unë po pres përgjigje nga ana juaj.

Mukades Gixhari . Faleminderit. Vazhdojmë tek të ndryshme. Kërkesë nga poeti z. He kuran Dedeji Shqyrtohet e njëjta kërkesë që na ka ardhur që në 15.7.2025. Bëhet fjale për një mbështetje financiare për botimin...

Mitat Daja . Për botimin e një libri. Tani...

Mukades Gixhari . E ka sjellë disa herë.

Mitat Daja . E ka sjellë disa herë. Është mirë që... është mirë që të ndihmohet një njeri që...

Mukades Gixhari . Atëherë ta hedhim në votim?

Edison Memolla . Kjo është kërkesë. Është kërkesë. Kërkesën që ta kthejmë projektvendim?

Mukades Gixhari . Jeni dakord që ta ...

Edison Memolla . Që të kthehet në projektvendim?

-Miratohet me 13-vota pro (mungon z. Sh. Kolgega dhe z. Erind Tosku në këtë votim) dhënia e pëlqimit që kërkesa e z. Hekuran Dedej të kthehet në projektvendim nga administrata dhe të vijë në mbledhjen e radhës për miratim.

Mukades Gixhari . Jemi dakord z. kryetar që nuk e kemi arritur që ta...

Edison Memolla . Mbajeni shënim kërksën.
(i drejtohet administratës)

Mukades Gixhari . Vazhdojmë dhe me një kërkesë tjetër: për mbështetje financiare të një ekskursioni social–edukativ nga Shoqata Humanitare “Tre Dhjetori”. zoti Rezart Vogli.

Silvana Aliu . Kjo është drejtuar gabim.

Renato Kalemi . Ajo i është drejtuar Rrogozhinës, thjeshtë në Kavajë kanë zyrën , i është drejtuar z. Memolla. Në Kavajë bën pjesë qendra e tyre.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK**

Alime Hoxha . Kush është shoqata se nuk dimë kush është shoqata.

Edison Memolla . Do marrim një informacion dhe do ju vemë në dijeni.

Mukades Gixhari . Keni ndonjë diskutim që ju ka ngelur merak? Atëherë, meqë nuk kemi diskutime, mbledhjen e deklaroj zyrtarisht të mbyllur.

MBYLLET MBLEDHJA

- Mbledhja deklarohet e mbyllur zyrtarisht rreth orës 15 : 30⁰⁰ . Video regjistrimi i kësaj mbledhjeje zgjati 02 orë 02 min ; 02 sek.
- Ky procesverbal mbyllet në faqen **58 (pesëdhjetë e tetë)**.

Miratohet procesverbali :

Zbardhi (transkriptoi) procesverbalin :

Sekretari i Këshillit

Ervis Shera